



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 30 qershor 2020, në mbledhjen e XXXII (tridhjetë e dy), të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në ish ndërtesën e Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç z.Agron Hyseni dhe znj.Fatlume Jaha që munguan (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe Drejtorët e Drejtorive të Administratës komunale, përfaqësues të mediave dhe OJQ-së SDK.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë e cila gjithashtu është thirrë në kushte dhe masa jo të zakonshme për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Shtoi, thirrjen dhe materialet i keni marrë me kohë, gjithashtu edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së, andaj konsideroj se mund të vazhdojmë me punë.

z.Vendenis Lahu, theksoi, dëshiroj të paraqesë një kërkesë të cilën e ka dërguar komunitetit i Orllnait, konkretisht pronarët e dyqaneve ushqimore të këtij fshati, kërkesë e cila shoqërohet me një petition të nënshkruar nga shumë banorë të atij lokacioni me të cilën kërkohet të shqyrtohet orari i punës së këtyre bizneseve përkatësisht dita e dielë të mos jetë ditë pushimi për shkak të specifikave të zonës. Ne mendojmë se është një kërkesë e arsyeshme prandaj edhe kërkoj që të hedhet në votim dhe të futet pikë shtesë e rendit të ditës dhe pastaj të diskutojmë për këtë çështje.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, lidhur me çështjen e ngritur nga parafolësi, unë më 13.06.2020 e kam potencuar përmes rrjeteve sociale një gjë të tillë ku në bazë të zhvillimeve që kanë ndodh në kohën e fundit kushtet ekonomike u janë vështirësuar bizneseve dhe në bazë të kërkesave të qytetarëve e më vonë edhe një kërkesë e cila na është drejtuar edhe neve si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e që e mbështesim këtë pjesë për shkak se shumë biznese janë në prag të falimentimit të tyre, ndër ato edhe në zonën turistike në fshatin Orllan të cilat ditën e dielë po mundohen ta shfrytëzojnë e që për ata dita e dielë është jetike, mirëpo edhe kërkesa nga bashkatdhetarët tanë të cilët vijnë në Kosovë këta dy muaj të verës është e tillë që bizneset të paktën këta dy muaj të jenë të hapura edhe ditëve të diela. Jemi në dijeni se bizneset në Komunën e Prishtinës punojnë të dielave andaj përse të maltretohen qytetarët dhe të shkojnë atje të kryejnë shërbime.

Unë propozoj që kjo të lejohet vetëm gjatë sezonit të verës, mirëpo për pjesën e cila është e ndjeshme, pjesa e Orllanit nëse ju pajtoheni mund ta lëmë gjatë tërë vitit.

z.Hasan Ajeti, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e kemi një kërkesë të tillë nga pronarët e dyqaneve në Orllan për ta bërë ndryshim plotësimin e Rregullores për orarin e punës së bizneseve. Gjykoj që çdo veprim të merret në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Secili prej neve jemi në dijeni rreth specifikave dhe gjendjes në terren andaj mbi atë bazë duhet të nxirret edhe vendimi. Interesi jonë është që të krijojmë kushte më të mira për bizneset në territorin e Komunës së Podujevës.

z.Avni Fetahu, theksoi, edhe një ditë më parë në mbledhjen e KPF-së e potencova dhe sërish propozoj që pikë e rendit të ditës të futet edhe plotësimi i përbërjes së KPF-së duke përfshirë edhe tërheqjen time nga pozicioni ku jam si anëtar i KPF-së në mënyrë që t'i hapet rrugë zëvendësimeve të nevojshme nga subjektet përkatëse politike që veç i kanë jap propozimet e tyre në seancën kaluar. **Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, deri tani kemi dy propozime për futje të 2 pikave shtesë në kuadër të rendit të propozuar të ditës. Sa i përket propozimit të parë kemi të bëjmë me një Rregullore e cila është në fuqi dhe që mendoj se kjo çështje paraprakisht do të duhej t'i dërgohej Ekzekutivi i Komunës. Pa dashur të ndërhyj në këto çështje rreth asaj zone e cila mund të cilësohet si zonë turistike dhe ka vizitor të shumtë, si do që të jetë unë do ta hedh në votim këtë propozim.

z.Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, theksoi, në emër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, konsideroj se iniciimi i kërkesës së bizneseve të fshatit Orllan është shumë reale por paraprakisht duhet të theksohet neni i cili parasheh orarin e punës ditëve të diela dhe për cilën kohë duhet të jetë në dispozicion kjo çështje. Nëse ju e parashihni se duhet të jetë deri më 01 tetor mund të them se është në dakord dhe mund të futet në rend të ditës e që faktikisht 3 muaj po ju japim mundësi edhe bizneseve në fshatin Orllan por edhe në pjesë tjera të Komunës së Podujevës përfshirë edhe qytetin sepse nuk dëshirojmë t'i diskriminojmë asnjë biznes edhe për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk jam në dijeni saktësisht se a është drejtuar kërkesa në fjalë në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik mirëpo ne kemi një Rregullore e cila është në fuqi. Propozimet që u bënë qoftë për lejim të punës së bizneseve të dielave në qytet qoftë në zonën e Orllanit si zonë turistike ngase sa unë kam lexuar zonat turistike janë të caktuara nga Kuvendi, mirëpo rreth kësaj çështje leje speciale nuk mund të nxjerrë askush kur kemi në fuqi një Rregullore e cila përcakton gjërat e tilla përkatësisht orarin e punës. Nuk është drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik prezent këtu sepse do të duhej të propozohej specifikisht që pika përkatëse e Rregullores e cila ndalon punën e bizneseve të dielave të plotësohet me zgjatjen e orarit të punës për Orllan dhe për kujdestaritë siç janë barnatoret, për një periudhë 3-5 mujore sa të jenë bashkatdhetarët këtu në Kosovë dhe të vendosim si Kuvend e që mendoj se nuk do të bënim shkelje ligjore sepse dy rregullore për të njëjtën çështje nuk mund të jenë fuqi, ose ose duhet të lëshojmë leje speciale për secilin subjekt afarist, kështu që është mirë ta dimë vetëm pikën (nenin) përkatës të Rregullores dhe pastaj të vendosim, pra ne të gjithë e kemi votuar që dita e dielë të jetë ditë pushimi andaj nëse e ndryshojmë atë tani është mirë të mos ketë konflikt me Rregulloren që është në fuqi.

z.Bajram Ajeti, theksoi, kërkesa është shumë e qartë, është drejtuar në formë të petitionit nga Orllani, andaj lëni tani bizneset tjera dhe mos të hym në çështje tjera.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për çështje të tilla të mos e praktikojmë të bëjmë debat sepse nuk lejohet me Rregullore të punës e Kuvendit që për propozime të tilla të bëhet debat ende pa u miratuar rendi i ditës, mandej pika shtesë mund të hynë në rend të ditës vetëm nëse ato janë të natyrës urgjente dhe të domosdoshme dhe jo çdo gjë që propozohet.

z.Avni Islami, theksoi, është e vërtetë se Orllani është zonë turistike në të gjitha periudhat, mirëpo duke pasë parasysh specifikat që i ka Kosova e që de-facto dhe de-jure Kosova është vend turistik për shkak se në periudhën qershor deri në fund të shtatorit i kemi mërgimtarët tanë këtu në Kosovë, andaj nuk mund të ndahet vetëm një zonë, për shkak se e tërë Kosova është zonë turistike prandaj mendoj që ne si Kuvend i Komunës jo vetëm zonën turistike të Orllanit por të gjitha bizneset tjera që

punojnë dhe e presin këtë periudhë verore është mirë t'i lejojmë të gjitha bizneset të punojnë duke përfshirë edhe orarin sa është e paraparë me ligj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, e vë në votim që kjo pikë të hyjë në kuadër të rendit të ditës si pikë e shtesë.

Pas votimit u konstatua që njëzëri përkrahet që të hyjë në rend të ditës si pikë shtesë, në pikën 6,

- ***Kërkesa / peticioni i një numri të pronarëve të dyqaneve ushqimore të fshatit Orllan për lejimin e punës edhe ditëve të dielave gjatë periudhës verore (ose me mundësi të zëvendësimit me një ditë tjetër të javës) - sipas asaj që u prezantua***

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, po ashtu kemi edhe propozimin e këshilltarit z.Avni Fetahu për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, duke përfshirë edhe tërheqjen e tij nga kjo përbërje, andaj e hedh në votim që hynë në rend të ditës si pikë e veçantë.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi për përfshirje si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës, në pikën 5,

- ***Ndryshimi dhe plotësimi i përbërjes së komitetit për Politikë dhe Financa***

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar duke përfshirë edhe 2 pikat shtesë që sapo u futen në rend të ditës dhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa sipas të cilave po ashtu është edhe 1 pikë shtesë.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar duke përfshirë edhe rekomandimet e KPF-së në kuadër të të cilave është edhe një pikë shtesë si dhe 2 pikat tjera shtesë të cilat u futen në këtë mbledhje, dhe atë;

- ***Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare (subvencionimi i ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet në gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit) që renditet në pikën 4.***
- ***Ndryshimi dhe plotësimi i përbërjes së komitetit për Politikë dhe Financa, që renditet në pikën 5,***
- ***Kërkesa / peticioni i një numri të pronarëve të fshatit Orllan për lejimin e punës së bizneseve edhe ditëve të dielave gjatë periudhës verore (sipas asaj që u prezantua) që renditet në pikën 6, kurse pika Të ndryshme kalon sipas radhës në pikën 7***

1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 02 mars 2020; 02 prill 2020; 22 maj 2020

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime u miratuan Ekstraktet procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 02 mars 2020; 02 prill 2020; 22 maj 2020

2. Korniza Afatmesme Buxhetore 2021/2023 e Komunës së Podujevës

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës është pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Republikës së Kosovës dhe është hartuar dhe përgatitur në përputhje me procedurat buxhetore të dhëna nga Ministria e Financave përmes Qarkores Buxhetore 2021/01. Me këtë dokument janë përcaktuar kufijtë fillestar buxhetor për Komunën e Podujevës në vlerë prej 23,181,801.00€ për vitin 2021 dhe atë të ndara; -granti për Administratë të përgjithshme 9,014,838.00€, granti për Arsim 9,546,585.00€, granti për Shëndetësi 3,073,967,00€ si dhe të hyrat vetanake 1,416,561,00€. Nëse e krahasojmë me buxhetin aktual të vitit 2020 kemi një zvogëlim prej 904,468.00€, e që kjo zbritje është reflektuar te granti i Arsimit për 761,782.00€ dhe te granti i Administratës për 277,982.00€, kurse granti për Shëndetësi ka shënuar rritje për 135,356.00€. Projektionet e buxhetit për vitin 2022 janë në shumën prej 25,758,356.00€ si dhe për vitin 2023 në shumë prej 26,498,227.00€.

Korniza Afatmesme Buxhetore 2021/2023 e Komunës së Podujevës paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve Komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare. Me këtë dokument paraqiten shpjegimet e politikave prioritare të tanishme dhe atyre afatmesme të Komunës së Podujevës si dhe projektionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbushë projektet prioritare që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2021-2023. Gjithashtu në këtë dokument kornizë kemi paraqitur vizionin, misionin dhe synimet e Komunës që rrjedhin nga Strategjia Zhvillimore Lokale, dhe atë: Vizioni - Komunë e suksesshme me mundësi për të gjithë, Misioni - Komuna e Podujevës e përkushtuar të ofrojë shërbime efikase që sigurojnë mirëqenie të qëndrueshme, dhe Synimet- zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, zhvillim i qëndrueshëm social dhe menaxhimi i qëndrueshëm.

Korniza Afatmesme Buxhetore reflekton perspektivën e politikave makro-fiskale si: Parashikimi i të hyrave komunale sipas llojeve të të hyrave, si dhe parashikimin e shpenzimeve buxhetore sipas programeve dhe kategorive ekonomike. Përmes këtij dokumenti jemi munduar që në mënyrë të qartë të paraqesim deklaratë të aktiviteteve, misionit dhe objektivave të Komunës për secilën Drejtori ku secila Drejtori ka një përmbledhje të aktiviteteve të nevojshme për të arritur misionin dhe qëllimin e saj, strategji për të arritur aktivitetet e nevojshme me një vlerësim të rreziqeve gjatë periudhës buxhetore dhe me një plan të përgjithshëm për të adresuar rreziqet.

Në fushën e shpenzimeve, Korniza Afatmesme Buxhetore përfshinë një projektion tre vjeçar të shpenzimeve të cilat mund të financohen nga granti qeveritar dhe të hyrat vetanake, shpenzimet e projektuara sipas Drejtorive gjegjësisht programeve dhe sipas kategorive të shpenzimeve siç janë: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, subvencione dhe kapitale, dhe që shpenzimet e parashikuara baraspeshohen me të hyrat e parashikuara.

Çdo Drejtori ka një mision të performances, masat janë të arsyeshme dhe ato mund të përmirësohen dhe të jenë indikator të vërtetë të performances, si dhe në këtë dokument janë trajtuar në mënyrë të veçantë, projektet për investime publike -PIP për një periudhë tre vjeçare, fushë kjo e cila përcakton kërkesat dhe nevojat direkte të qytetarëve të Komunës së Podujevës. Lista e projekteve kapitale është e ndarë për tri vitet e ardhshme sipas periudhës për të cilën mendojmë që këto projekte do të implementohen, projekte që mendohet të financohen nga granti qeveritar si dhe nga të hyrat vatanake pa përjashtuar mundësinë e financimit edhe nga donatorët e ndryshëm, qoftë ata të brendshëm ose të jashtëm.

Te nderuar kjo kornizë është hartuar në bazë të kufijve fillestar të Qarkores 2021/01 të Ministrisë së Financave, Qarkore e cila sigurisht do të pasohet edhe me qarkore tjera me të cilat do të përcaktohen kufijtë final të buxhetit për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022/23, dhe marrë për bazë Qarkoret e ardhshme të Ministrisë së Financave, do të përgatitet buxheti për vitin 2021 dhe projeksionet për dy vitet pasuese, mirëpo ky dokument i tanishëm do të jetë bazë për hartimin e buxhetit final për vitin 2021, si dhe mbesim me shpresë se me Qarkoret tjera do të kemi një buxhet më të favorshëm për Komunën e Podujevës.

Për fund ju ftoj që ta miratoni këtë propozim Kornizë Afatmesme Buxhetore 2021/23 të Komunës së Podujevës, duke përfshirë edhe korrigjimin e një gabimi teknik dhe atë; në faqen 9 të dokumentit 9, tabela nr. 3, rreshti nr.15 Arsimi kolona Stafi, ku numri i lejuar duhet të jetë 1462 e jo ashtu siç figuron në dokument 11462.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, draft dokumenti që sot kemi para vetës është një përmbledhje e një numri të madh të projekteve që parashihen të realizohen gjatë periudhës kohore 2021-2023 që synon të përbush edhe detyrimin e Komunës për një jetë më të mirë për qytetarët e saj.

Duke parë kapacitetet buxhetore secila Drejtori ka paraqitur projektet prioritare dhe së bashku me kërkesat e qytetarëve. Ndërtimi i objekteve shkollore, ndërtimi i shtëpive për familjet në nevojë, rritja e qendrave të mjekësisë familjare, ndërtimi i hapësirave sportive dhe projekte të shumta infrastrukturore që përfshihen brenda këtij draft dokumenti. Investimet në bujqësi po ashtu janë me një rëndësi të veçantë sepse viteve të fundit kemi vërejtur se qytetarët e Komunës së Podujevës janë orientuar shumë në kultivimin e kulturave bujqësore dhe në blegtori, prandaj projektet dhe subvencionet e realizuara në vitet e kaluara dhe ato që parashihen të realizohen në vitet në vijim ndihmojnë shumë bujqit tanë të dalin sa më të suksesshëm, andaj për këto dhe arsye tjera ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim propozim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023 të Komunës së Podujevës.

z.Vendenis Lahu, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore është një nga dokumentet kryesore që miraton asambleja komunale dhe është dokumenti i tretë të cilin po e shqyrtojmë në këtë mandat. Në dy Kornizat Afatmesme paraprake i kemi dhënë vërejtjet tona për nivelin jo të kënaqshëm profesional për planifikimin ashtu edhe për prioritetet se kah do të drejtohen mjetet buxhetore për periudhën që parasheh Korniza dhe fatkeqësisht po na bie t'i përsërisim vërejtjet tona për arsye se kjo qeverisje vazhdon të qëndroj keq dhe t'i përsërisë gabimet e njëjta e që rrjedhimisht edhe ne po detyrohemi ta përsërisim vetveten. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve duhet të ndërtohet në mbështetjen e prioritetëve zhvillimore që ka Komuna, qoftë Planin Zhvillimor Komunal apo strategjitë zhvillimore e që një pjesë të këtyre dokumenteve nuk i ka fare Komuna apo i ka të ndërtuara jo mirë sikurse këtë Kornizë.

Ne si LVV i kemi dhënë vërejtjet tona gjatë shqyrtimit të Planit Zhvillimor Lokal duke i kundërshtuar investimet dhe politikat që ka kjo qeverisje e cila vazhdon me logjikë të njëjtë që 20 vite dhe që sot na ka sjellë në këtë gjendje për shkak të qeverisjes pa vizion dhe të korruptuar. Edhe në këtë Kornizë buxhetore fatkeqësisht orientimet e kësaj qeverisje vazhdojnë të jenë projektet për asfaltimin e rrugicave që po ndërtohen (shkel e shko) e që në fakt as projekte infrastrukturore nuk janë por kryesisht asfalt për qëllime elektorale e ekonomike të grupeve të caktuara. Korniza Afatmesme Buxhetore si një projeksion i të hyrave dhe shpenzimeve për vitet 2021-2023 ka probleme si në aspektin e të hyrave të planifikuara ashtu edhe të shpenzimeve, buxheti i Komunës së Podujevës në bazë të planifikimeve afatmesme të shpenzimeve parashihet të rritet kryesisht nga granti qeveritar dhe shumë pak nga të hyrat vetanake, ne në vazhdimësi e kemi potencuar duke u bazuar edhe në raportet e auditimit se në Komunën e Podujevës janë

shumë prona të cilat nuk tatohen në sistemin e tatimit të pronës e që normalisht nëse këto do të tatoheshin do të rriteshin edhe të hyrat vetanake dhe do të kishte një trajtim.

LVV nuk e voton këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore ku buxheti orientohet kryesisht në asfalt për arsye se konsiderojmë se është orientim i gabuar dhe që nuk sjellë zhvillim të gjithmbarshëm ekonomik shoqërorë brenda mundësive të Komunës. LVV kërkon t'i jepet prioritet arsimit, prodhimit vendor, kulturës dhe sportit, prandaj edhe e kundërshtojmë këtë Kornizë e cila vazhdon duke i bartur problemet e vjetra dhe duke krijuar probleme të reja ekonomiko-sociale. Do të votonim për këtë Kornizë buxhetore vetëm në rast se merren parasysh propozimet tona ku një pjesë të tyre i kemi paraqitur edhe në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal e që për fat të keq të qytetarëve tanë nuk janë marrë parasysh as në këtë Kornizë dhe që ne po i përsërisim sërish e të cilat shumë shpejt do të gjejnë zbatim me mbajtjen e zgjedhjeve lokale të pezulluara nga LDK në bashkëpunim me Presidentin për qëllime të pastra politike për të shtyrë fitoren e pashmangshme të LVV-së veç edhe për pak kohë. Propozimet tona që i kemi paraqitur edhe për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal, një pjesë të tyre do t'i paraqesim edhe sot, dhe atë;

- Ndarja e 500,000.00€ për zonën ekonomike sepse 80,000.00€ sa janë paraqitur mendojmë se janë të pamjaftueshme;

- Çdo vit të ndahen nga 500,000.00€ për subvencionimin e bizneseve prodhuese, pra të subvencionohen 10% e makinerive të blera me qëllim të instalimit të linjave të reja të prodhimit;

- Të ndahen 1 milion euro për renovimin e shkollave, kur e dimë gjendjen infrastrukturore të objekteve ekzistuese;

- Të ndahen 200,000.00€ për furnizim të shkollave me kabinete të shkencave natyrore, si Fizikë, Kimi dhe Biologji;

- Të ketë rritje të subvencioneve në fushën e bujqësisë ku për çdo vite të ndahen nga 500,000.00€ dhe të drejtohen në bujqësinë intenzive dhe përmes përkrahjes edhe të biznesit prodhues në fushën e ushqimit të ndihmohet krijimi i zinxhirit të prodhimit;

- Në fushën e shëndetësisë përveç tjerash të ndahen mjete për investime për zhvillimin e patronazhit;

- Të parashihen 2 milion euro për dy vite për ndërtimin e shtëpisë së kulturës;

- Të ndahen 300,000.00€ për renovimin dhe adaptimin e objektit aktual të kulturës me qëllim që të kthehet në Bibliotekë të qytetit me qëllim që objekti të jetë i rregulluar vërtetë ashtu siç duhet të jetë një objekt i Bibliotekës;

- Të ndahen 200,000.00€ për subvencionimin e klubeve sportive kur dihet gjendja shumë e rëndë ekonomike e klubeve sportive në Komunën tonë dhe ku një pjesë e klubeve me traditë në qytetin tonë janë vetëm në një funksion formal;

- Të ndahen 200,000.00€ për gjelbërimin e qytetit.

Pra këto janë propozimet tona dhe të cilat nëse pranohen LVV do ta votonte Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023 të Komunës së Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nuk është e lejuar të behet fushatë politike nga foltorja e Kuvendit ashtu siç e bëri parafolësi, andaj të fokusohemi në tema përkatëse dhe të mos bëhet fushata të tilla me paragjykime të tilla.

z.Bashkim Sylja, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore, është dokument i cili detyrimisht prezantohet dhe miratohet nga Kuvendi i Komunës, dhe përmes këtij dokumenti Qeverisja Lokale përcakton parametrat dhe prioritetet për zhvillimin e Komunës.

Dokumenti është ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore 2021/2023 sipas të dhënave nga Ministria e Financave përmes Qarkores Buxhetore 2021/01.

Sipas tabelës shihet se për vitin 2021 granti i përgjithshëm është planifikuar 278,000.00€ më pak se në vitin 2020 dhe granti në Arsim 761,000.00€ më pak se në vitin 2020.

Teatri “Avdush Hasani” për tri vitet rresht është planifikuar shuma e njëjtë 129,000.00€ e që besoj se drejtori do të na e sqaroj këtë çështje.

Të gjithë e dimë se për shkak të pandemisë buxheti i vitit 2021 do të jetë më i vogël se ky i vitit 2020 dhe atë për afër 900,000.00€, mirëpo te tabela nr. 2 kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave të sqarohemi për licencat dhe lejet të vitit 2019 ku janë paraqitur 200,000.00€ kurse për vitet 2021/22/23 janë paraparë 100,000.00€ më pak, si dhe pastaj te taksat tjera komunale nga 104,000.00€ në 43,000.00€. Shpenzimet kapitale për vitin 2021 janë të planifikuara më pak se në vitin 2020, edhe pse unë mendoj që edhe ky vit do të jetë një sfidë sa i përket realizimit të projekteve për shkak të procedurave, kohës dhe çështjeve të tjera.

Për paga dhe mëditje në vitin 2019 kanë qenë rreth 12,000,000.00€, në vitin 2020 janë paraqitur 14,000,000.00€ andaj përse është kjo diferencë kaq e madhe, a ka pasur te punësuar me kontrata mbi vepër, apo janë paguar mëditje për staf më shumë, duke pas parasysh që në vitin 2021 janë planifikuar 13,000,000.00€. Te strategjia zhvillimore për sektorët Komunal, konstatimet që i keni shënuar në fund të këtij dokumenti te Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, citoj, mungesa e mjeteve, shkurtime financiare dhe në numër të punëtorëve ndikojnë për mos përmbushjes së misionit të kësaj Drejtorie, si dhe nëse të hyrat vatanake nuk realizohen sipas planit, do të vij deri te reduktimi i projekteve të miratuar në Kuvend, nga i njëjti konstatim shënon edhe te Drejtoria e Arsimit, gjë që unë nuk pajtohem me ju duke ditur rëndësinë e këtyre dy Drejtorive dhe po të thuhej një gjë e tillë për Drejtori tjera fare nuk do t’i përmendja.

Te parashikimi i projekteve nuk e kam vërejtur se keni planifikuar të ndërhyni në pastrimin e disa lumenjve përveç lumit Llap, andaj duke qenë në dijeni se para disa ditëve ka pasur vërshime në disa fshatra të Komunës së Podujevës ku vetëm në fshatin Siboc me dhjetëra shtëpi janë goditur, pa llogaritur edhe dëmtimet në kultura bujqësore, pa anashkaluar edhe fshatrat tjera që kanë qenë të goditura nga ai vërshim. Në seancat e kaluara kam dhënë vërejtje për investimet nëpër fshatra e që edhe kësaj radhe mund të them se keni bërë diferencime, unë mendoj që investimet duhet të bëhen në bazë të nevojave, gjerësisë së fshatrave dhe numrit të banorëve.

z.Adnan Zymeri, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore si bazë për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimit të prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2021/2023 është dokument i rëndësishëm së veçantë i cili përcakton domenet buxhetore dhe tërësinë e projekteve nga Urbanizmi deri tek Kultura dhe Sporti, dhe në këtë kuadër Komuna e Podujevës bazuar në programin qeverisës fitues si dhe në përputhej me kërkesat e qytetarëve ka planifikuar projekte si Sheshi i Dëshmorëve si projekti më i madh urbanistik i pasluftës në Komunën tonë si dhe asfaltimin e rrugëve tjera për të përmirësuar infrastrukturën në qytet dhe fshatra. Po ashtu ndër projektet kryesore të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit do të jetë shtrirja e ndriçimit publik në arteriet kryesore që lidhin qytetin me fshatrat përreth duke mos harruar edhe vazhdimin e shumë projekteve tjera të rëndësishme siç janë kalesat, trotualet, shenjëzimi, rregulli i shtretërve të lumenjve etj.

Pararendëse e këtij diskutimi do të jetë edhe ndarja e mjeteve për ndërtimin e shtëpive për familjet në nevojë që së bashku me 100,000.00€ e planifikuara nga Drejtoria e Shëndetësisë për vitin 2021 progresivisht do të ndikohet në përmirësimin e kushteve të banimit dhe jetesës për këtë kategori. Me 40,000.00€ Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të përmbyll një projekt shumë të dobishëm dhe të domosdoshëm për të identifikuar tokën e secilit bujk të vyer të Podujevës se cilës kulturë bujqësore i përgjigjet ajo tokë. Pastaj me projektin për drunjtë dekorativ do të ndikojmë në estetikë dhe përmirësim të kushteve të ambientit.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe me 50,000.00€ të ndara nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit jam shumë i lumtur që kërkesa ime në Kornizën Afatmesme Buxhetore të vitit të kaluar po jetësohet dhe të rinjtë llapjan do të kenë qendrën rinore që do të shërbej edhe si qendër inovacioni ashtu siç e meritojnë. Prandaj të nderuar koleg duke i mirëpritur imputet e juaja të rëndësishme në këtë fazë, ju ftoj që ta votoni këtë dokument.

znj.Endritë Murati, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore për Komunën e Podujevës është një dokument ndër kryesor me rëndësi strategjike në jetësimin e objektivave të identifikuar zhvillimore. Praktikisht, ky dokument edhe nga përkufizimi i tij është instrumenti i krijuar për të mundësuar ndërlidhjen ndërmjet politikave zhvillimore që hartohen sipas metodave të planifikimit strategjik si dhe reflektimit të tyre në proceset buxhetore. Pasqyrimi i caqeve të përgjithshme i të hyrave dhe shpenzimeve si dhe e gjithë struktura e tyre sipas kategorive ekonomike duhet të na japë mundësinë të shohim se Komuna i ka integruar mirë prioritetet e saj me procesin e zhvillimit të buxhetit dhe se ato që qytetarëve u janë thënë se janë prioritet, do të përkthehen edhe në mbështetje buxhetore. Me këtë dua të them se ky dokument është i një rëndësie të veçantë dhe duhet të ketë vëmendje të posaçme, fillimisht të ekzekutivit pastaj të Kuvendit, por edhe të medias e shoqërisë civile në Komunën tonë.

Planifikimi strategjik, konkluzionet e tij, mënyra se si janë hartuar politikat janë tejet të rëndësishme për përmbajtjen që do ta ketë ky dokument dhe me vet rezultatin që do ta ketë procesi i orientimit të resurseve buxhetore të Komunës në kuptimin e arritjes së objektivave për zhvillim të qëndrueshëm lokal. Strategjitë zhvillimore dhe efikasiteti i tyre, varen shumë nga cilësia e hartimit të tyre. Pika themelore e çdo procesi është analiza e gjendjes aktuale e cila kërkon hulumtim të të dhënave në mënyrë krejtësisht objektive, grumbullim dhe përpunim të informatave dhe konstatim objektiv të gjendjes. Hapat të rëndësishëm janë kornizë logjike që ndjekin përcaktimin e vizionit dhe të objektivave zhvillimore si dhe rrjedha logjike e kriterëve të planifikimit të cilat pikë orientuese e kanë analizën e gjendjes.

Unë kam dilemat e mia nëse Ekzekutivi i Komunës i ka përfillur siç duhet kriteret dhe kërkesat profesionale të planifikimit strategjik në kohën e hartimit të strategjive që janë miratuar nga Kuvendi i Komunës, dokumente të cilat janë kyçe për të siguruar e monitoruar mirëqeverisjen me resurset publike dhe fatkeqësisht në Komunën e Podujevës nuk u kushtohet ndonjë rëndësi më të madhe se sa thjesht kalimi i tyre si procedurë formale për shkak të obligimeve ligjore, dhe duke qenë kështu, unë jam e bindur se përmbajtja që reflektohet në Kornizën Afatmesme Buxhetore, nuk është rrjedhim i një procesi të planifikimit të mirëfillt strategjik që vjen si rezultat i një studimi të themeltë të nevojave emergjente apo të identifikimit të sektorëve me potencial më të lartë zhvillimor ekonomik në të cilën pastaj do të duhej të orientohej edhe buxheti. Kështu ne jemi dëshmitarë edhe nga e kaluara e afërt dhe e largët, por që do të vazhdojë edhe në të ardhmen se shpenzimi i buxhetit në Komunën e Podujevës vazhdon të mos i japë rezultatet e pritshme në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social të Komunës, madje të gjithë ne e shohim se procesi i shpenzimit të buxhetit të Komunës në çfarëdo periudhe që analizohet, qoftë vjetore apo 3 vjeçare, nuk siguron parimin e vlerës për para, kjo sepse siç u tha më lartë, ka probleme të shumta në planifikim e po ashtu siç na e thonë edhe raportet e auditorit, ka probleme edhe në administrim dhe ekzekutim të projekteve të të gjithë buxhetit. Përdorimi ad-hoc i të mirave publike vazhdon të mbetet një nga problemet themelore të qeverisjes në Komunën tone.

z.Pajtim Balaj, theksoi, e kam lexuar këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore dhe mendoj se është një planifikim shumë i dobët, sipërfaqësor, jo konkret dhe i shoqëruar me gabime të tmerrshme logjike dhe drejtshkrimore, përmbajtësore, madje ka gabime drejtshkrimore në pjesën ku unë besoj se është hartuar prej Drejtorisë së Arsimit, paramendoje Drejtoria e cila synon të rritë

cilësinë e arsimit në Komunë, na paraqet një raport me kaq shumë gabime drejtshkrimore, mendoj se ky është problem serioz edhe pse e di që nuk trajtohet seriozisht pothuajse kurrë njëherë. Unë kam pasë një pikë të diskutimit për qendrën rinore meqë nuk është specifikuar për çka janë planifikuar 50,000.00€ për vitin 2021, u sqarova tani por kjo është një ndër arsyet përse unë do të votoj kundër këtij plani dhe kundër kësaj Kornize.

Mendoj se nuk është prioritet ndërtimi i një qendre rinore para ndërtimit të qendrës së kulturës, dhe është një arsye tjetër që qëndron prapa kësaj sepse përveç nevojës më të madhe që është qendra e kulturës është tjetra që qendra rinore në Podujevë e cila vepron në kuadër të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal e cila nga themelimi i saj ka shërbyer si institucion për rekrutim të aktivistëve politik të LDK-së, pra kjo është arsyeja e dytë përse unë nuk do ta votoj.

z.Bunjamin Hoti, theksoi, nuk dola që të mbaj ndonjë rezyme apo dika më gjatë rreth planit që ne e kemi përpara por vetëm si çështje, meqë u cek nga LVV lidhur me qendrën rinore, ju them se qendra rinore dhe Këshilli i Veprimit Rinor Lokal – KVRL janë dy institucione të ndara rinore të cilat janë të rregulluara me Ligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.

KVRL funksionon si e veçantë dhe është mekanizëm e cila grumbullon të gjitha OJQ-të në që veprojnë në Komunën e Podujevës, ndërsa qendra rinore është institucion i cili licencohet dhe përbëhet nga OJQ-të, rrjedhimisht OJQ-të të cilat veprojnë në Komunën gjegjëse kanë të drejtë të aplikojnë për tu licencuar si qendër rinore, ndërsa Komuna e Podujevës deri më tani ka pasë një objekt i cili ka shërbyer si qendër rinore vetëm përkohësisht por që nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe nevojat si qendër rinore që të jetë e licencuar publike dhe tani në bazë të vendimit të fundit që ka marrë edhe Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe kërkesës së Komunës së Podujevës i është lejuar Komunës së Podujevës dhe ndihmohet që të ndërtohet një qendër rinore publike e cila i plotëson kushtet tamam ashtu siç parashihet me Ligjin përkatës.

Sa i përket shtëpisë së kulturës, pa dyshim se edhe ajo ka nevojë që të ndërtohet mirëpo nuk do të doja të vë në një peshojë se cila ka më shumë nevojë për arsye se, unë për një kohë kam qenë drejtor i qendrës rinore, dhe jam në dijeni sa është e nevojshme për rininë e Komunës së Podujevës, por jo vetëm, që ta kenë një qendër ku do të kenë mundësi të debatojnë, të kenë hapësira të leximit, të kenë amfiteatër, të kenë hapësira të cilat do të jenë të pranueshme në mënyrë që të licencohet një qendër rinore publike, ndërsa unë do të thoja që Podujeva jemi vonuar paska për ndërtimin e një qendre rinore publike deri tani, se jo që jemi për nguti.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dëgjova gjitha diskutimet e zhvilluara deri më tani, nuk mund ta përjashtoj faktin se në këtë dokument të Kornizës Afatmesme Buxhetore janë përfshirë disa projekte të cilat janë të nevojshme, por me rëndësi është se si kjo qeverisje aktuale e cila do të pasoj me ndonjë qeverisje tjetër e ka parë Podujevën me këtë dokument, pra është shumë me rëndësi sepse kemi të bëjmë me parashikime të punëve trevjeçare dhe mjetet e ndara nga Drejtoritë, shumë me rëndësi është se kah po orientohet apo kanalizohet Podujeva dhe si ne e shohim Podujevën me këto mjete në vitin 2022/23 me këto mjete të ndara, pavarësisht nga pozita jonë ku jemi, ku do të jemi ose si qytetarë të këtij vendi. Shumë me rëndësi është që ta dim ne tani që Drejtoria e Arsimit me këtë drejtor aktual ka vendosur që deri më 2023 të mos e ketë asnjë laborator sepse nuk ka paraqitur kërkesa për mjete buxhetore për një gjë të tillë e që besoj se do ta votonim sepse është interes i përgjithshëm, pavarësisht subjekteve politike dhe mendimeve ndryshe që i kemi.

Këshilltari parafolës z.Bunjamin Hoti e tha se kam qenë drejtor i qendrës rinore, është me rëndësi se nuk ka përfaqësuar rininë por ka përfunduar në subjekt politik. Shumë me rëndësi është që Podujeva do ta ketë qendrën rinore, dhe në atë të mos i futë duart asnjë subjekt politik sepse janë qendra ku rinia bënë debate dhe aktivitete tjera të ndryshëm, por e di që të gjitha

subjektet politike kanë tendenca që t'i politizojnë edhe ato elemente, sikurse që kanë edhe për të moshuarit, bujqit dhe gjitha kategoritë tjera dhe nuk ka kurrfarë diskutimi këtu.

Pastaj do të ishte shumë me rëndësi që sot ta dinim se Podujeva do të ketë më shumë Çerdhe publike, por që tani po e dimë se deri në vitin 2023 nuk do të ketë tjera dhe do të mbetet ajo që është pavarësisht përmbushjes së kapaciteteve dhe kërkesave të prindërve llapjan që janë të punësuar. Po ashtu është shumë me rëndësi se do të ketë shumë më pak kënde për të moshuarit dhe për fëmijët tanë si kënde lojërash, parqe pushimi për të moshuarit etj. Mandej u tha se do të ketë drunjë dekorativ mirëpo unë po ju them se shumë pak përshtypje të bëjnë drunjtë dekorativ sepse nuk ka fare, me përjashtim që ndoshta në shesh do të ketë dhe do t'i jap element dhe pamje më të mirë, por që parqet e Podujevës shumë pak të bëjnë përshtypje e që mendoj se është shumë me rëndësi, dhe tani unë e di se në qoftë se Podujeva parashikohet që deri në vitin 2023 të orientohet në drejtime të kanalizimeve, drejtime të infrastrukturës të papërfunduar, janë shumë të nevojshme por që jemi tepër të vonuar në këtë aspekt.

Sa i përket sektorit të bujqësisë, jam që të rritet dhe të fuqizohet buxheti për bujqësi dhe do të mbështesim fermerët dhe Drejtorinë aktuale e cila sjellë propozimet e që ne secili duhet ta ngrehim dorën dhe ta votojmë, mirëpo e kemi edhe dështimin e fermerëve të agrikulturës apo perimekulturës, jemi në dijeni se mjedra ka dështuar në Llap edhe se USAID në një formë është munduar dhe ka përkrahur këtë kulturë, pa dashur të anashkaloj edhe Ekzekutivin e Komunës. Pra me përjashtim të buxhetit të planifikuar për analiza të tokës diçka më shumë nuk kam vërejtur se është paraparë. Çështja tjetër, është e papranueshme që fermerët të rreshtohen në shesh këtu sikurse të jen para një gjykate, ku drejtori përkatës del dhe ju tregon se janë përfitues të një subvencioni, shembull sistemin pikë-pikë, andaj i nderuar drejtor, në mënyrë morale e them se është e papranueshme që fermeri të thirret në qendër të Podujevës, t'i vëhen gjërat përpara dhe ai të rrijë i gatitur para qeverisjes, kushdo qoftë ai, fermeri e merr motokultivatorin, shembull, dhe shkon në arë, pra duhet ta ndryshojmë mentalitetin tonë të qeverisjes.

Është politizim ajo që e përmendi ish kryetari i qendrës rinore sepse ka pozitë në atë qendër, merr buxhet prej Komunës dhe përfundon në atë subjekt politik. Nëse ti koleg z.Bunjamin Hoti si ish drejtor i qendrës rinore të Llapit mund t'i rendit tri pika që rinia llapjane me Ju kryetar apo drejtor, ka bërë diçka, unë ta fuqizoj buxhetin dhe thërras të miratohet.

Kështu që në këtë Kornizë, unë personalisht Podujevën e shohë pa këto elemente që i ceka, me një sistem pikë-pikë, me një fermer i cili rrinë gatitur para Kryetarit të Komunës dhe drejtoritë të Drejtorisë përkatëse, i cili denigrohet para mediave, mandej e shoh një kryetar të rinisë i cili bënë politikë në qendrën e pavarur rinore, e shoh Podujevën pa Bibliotekë por me libra nëpër bodrume e që është dashtë të ndahej një buxhet për renovimin e ish objektit të Komunës dhe t'iu lejohej edhe shoqatave të luftës, edhe për Bibliotekë, edhe për Shoqatën e pensionerëve të cilët rrinë nëpër kafe dhe e rrugë, me qira e pa qira, dhe shoqata dhe OJQ tjera të Podujevës të akomodohen në atë objekt, por që nuk është paraparë asnjë buxhet edhe pse drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit na ka premtuar se me lirim e objektit në fjalë do të bëjë kërkesë për këto gjëra. Mandej e di që drejtori i DKA-së nuk ka paraparë asnjë laborator deri në vitin 2023, andaj nuk po mund ta dijë cili këtu me moralin e tij 100% e voton këtë dokument, atëherë ose duhet të abstenoj ose duhet ta kthej dokumentin dhe të bëhen kërkesa shtesë si, shembull, për një laborator sa do që të jetë i vogël do të kishte qenë elementi i parë i një nxënësi për të bërë një eksperiment kimik ose fizik e që të paktën me 30,000.00€ do të mund të ndërtohej, por që nuk keni edhe asnjë epruvetë në shkollë, kështu që i nderuari Kryesues unë kërkoj falje por besoj se të gjithë ne duke përfshirë edhe Nënkryetarin e Komunës nga këtu dhe duke u bazuar në këtë dokument ne e shohim pasqyrën e Podujevës deri në vitin 2023, andaj nuk mund ta lavdërojmë

bash ashtu këtë Kornizë, por vetëm po e them ashtu siç mendoj dhe si i shohë Podujevën deri në vitin 2023, dhe rrjedhimisht nuk mund ta mbështesim këtë Kornizë dhe këto parashikime, duke përjashtuar disa projekte të cilat veç e veç i mbështesë sepse janë të nevojshme por tash ky dokument mund të votohet si tërësi.

z.Pajtim Balaj, theksoi, pretendimi im që qendra rinore dhe KVRL-ja janë një farë mekanizmi për rekrutim të aktivistëve politik, veç u konfirmu prej ish kryetarit të qendrës rinore i cili tani është edhe pjesë e strukturave dhe kësaj asambleje nga radhët e LDK-së, kurse sa i përket OJQ-ve dhe disave që janë listuar ne jemi në dijeni se ato janë Organizata Joqeveritare të qeverisë lokale, ka shumë OJQ që nuk figurojnë në listë, nuk kanë qasje dhe nuk mund të përfshihen në aktivitete të qendrës rinore të KVRL-së sepse duhen të plotësohen disa kriteret partiake e të tjera.

z.Bunjamin Hoti, theksoi, me gjithë respektin për kolegun nga radhët e PDK-së (Rafet Llapashtica) i cili vërejtta se ka një interesim dhe i përcjellë disa çështje të mijat edhe kështu personalisht në aktivitetin tim politik. E vërteta është se na lejohej që shembull deri dje të jemi në shoqëri civile kurse sot në parti politike dhe në këtë aspekt shumica e aktivistëve të shoqërisë civile pothuajse veç e bëjnë këtë rrugëtim.

Çështja tjetër, e vërejtta se disa gjëra nuk po i keni të qarta sepse nuk ka kryetar të qendrës rinore por ka drejtor gjë që ndoshta është një detaj por që ju nuk po i dini, dhe meqë nuk po i dini unë e di që kur kam qenë drejtor i qendrës rinore asnjëherë nuk ka pasë interesim prej asnjërit prej partive politik qoftë nga pozita qoftë nga opozita që të vijnë dhe të shohin se si janë kushtet e qendrës rinore, fjala është për asamblistë e që u paska dashtë të na ndaj buxhetin në atë kohë.

Unë këtu jam asamblist dhe koleg me ju por nuk jam i obliguar të jap raport as juve si opozitë as pozitës për veprimtarinë time që e kam bërë. Raportet i kam bërë Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit përkatësisht ish drejtorit të nderuar z.Nexhmi Balaj.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, fillimisht i them parafolësit z.Bunjamin Hoti se nuk mendoj fare për ju, madje vetëm kur ju shohë më bie ndërmend për ty, mirëpo secili mund të veproj si të dojë me buxhet të vetin personal, mund edhe ti hedh në kontejner, por ku merr buxhet prej një institucioni në këtë rast prej DKRS-së që keni marrë ju si drejtor i qendrës rinore, sepse keni pas një drejtor të DKRS-së ashtu si ti, sepse po të ishte tjetër drejtor nuk do të mund ta bënit një gjë të tillë, kushdo qoftë ai. Po të isha unë drejtor nuk do t'ju lejoja të shkoni në atë drejtim që ju e zgjedhni të gabuar dhe duhet të jepni llogari për mjetet publike, si për 1 euro si për 100,000.00€. Ne e kemi rritë buxhetin për rini këtu në Kuvend, pastaj sa është politike tregon vetëm një fakt ku ju keni propozuar këtu për një komision një përfaqësuese të shoqërisë civile anëtarin e juaj të rinisë dhe e cila ka qenë kandidate për asamble komunale, nuk po dëshiroj të merrem më gjatë me këshilltarin në fjalë sepse atë që e them e them me fakte. Edhe njëherë i kërkoj të del në foltore dhe të tregoj sa mjete buxhetore ka pranuar nga DKRS si drejtor i qendrës rinore dhe po ashtu tregoni sa punë unifikohen me ju si drejtor i asaj qendre, gjë të cilën mund ta bëni por edhe mund të mos e bëni, unë vetëm po kërkoj sepse gjykatës nuk jam.

z.Avni Islami, theksoi, kam një pyetje sepse nuk e kam të qartë këtu në Kuvendin e Komunës, qoftë parafolësi apo të tjerët që kërkojnë shifra, a është i obliguar që këshilltari t'i raporton me shifra një këshilltari tjetër, nëse po dhe nëse ka mundësi atëherë t'i sjell të dhënat e kërkuara nëse jo atëherë të mos zgjatet kjo temë.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, sa i përket asaj që kolegu nga radhët e LDK-së e tha se lejohej që të jesh në shoqëri civile e pastaj me dal në subjekt politik, pajtohem dhe normal që lejohej mirëpo kolegun në fjalë z.Bunjamin Hoti prej që unë e mbaj mend, prej klasës XI në Gjimnaz ka shpërnda lista për anëtarësim në LDK, kështu që para klasës së XI nuk e di ku keni mund të jeni në shoqëri civile.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, nuk dëshiroj të ndalem në detaje lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, vetëm se dua të theksoj disa çështje që Komuna jonë ish dashtë t'i ketë por që fatkeqësisht për shkak të keqqeverisjes dhe keq planifikimit ato mungojnë. Vite me radhë jeni në pushtet dhe nuk kemi çerdhe të reja të ndërtuara, nuk kemi asnjë stacion të ndërtuar për qentë endacak të cilët bredhin nëpër rrugët e qytetit e sidomos pushimin e bëjnë zakonisht përreth ndërtesave kolektive, para bankave të qytetit dhe u pamundësojnë qytetarëve qasjen në banka, e mos të flasim për oborrin e shtëpisë së shëndetit ku aty e kanë bujtinën.

Asnjë kënd i lojërave për fëmijë, asnjë park i rregulluar për të kaluar këto ditë me vapë dhe atë pak park që e kemi është tërësisht i pa mirëmbajtur. Asnjëherë nuk kemi hasur se kemi ndonjë program për mbrojtjen e ambientit jetësor, asnjë sipërfaqe gjelbëruese me pemë, fidane dhe lule sezonale të mbjella. Oborri i shtëpisë së shëndetit më shumë ngjason në një parking privat se sa në një institucion shëndetësor e mos të flasim për oborret e shkollave ku shpesh herë kullosin bagëtitë. Stacioni i autobusëve nuk i plotëson as kushtet minimale për punë kur dihet se është stacioni i vetëm e mos të flasim për vetëquajturët stacione të autobusëve ku shumicën e rasteve autobusët parkohen pothuajse në rrugë. Parku mbrapa kafiterive në park ngjason me një vend të frikshëm pa ndriçim, pa ulëse por që ai vend shfrytëzohet për dukuri negative nga të rinjtë tanë. Për të rinjtë llapjan aq pak është menduar sa që kohen e lirë ata mund ta kalojnë vetëm nëpër kafiteri pasi që Komunës tonë i mungon qendra rinore sikurse që ishte pas luftës ku të rinjtë mund t'i ndiqnin kurse të gjuhëve të huaja dhe aktivitete rekreative, mungon galeria, atelieja dhe muzeu, e mos të flasim për trashëgimin kulturore që nuk është bërë asgjë.

Pra kolegë të nderuar ky Ekzekutiv prioritet kryesor ka kanalizimin dhe asfaltin jo cilësor.

z.Avni Fetahu, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore është një nga dokumentet e rëndësishme që do të duhej të pasqyronte zhvillimin ekonomik lokal në të gjitha sferat ku preket jeta e qytetarit, por për tu realizuar kjo natyrisht se duhet një planifikim profesional e përmbajtësor i kësaj Kornize e që ne e vlerësojmë se kësaj Kornize buxhetore i mungon një planifikim i tillë.

Po filloj nga pika 2, deklarata e Komunës në lidhje me prioritet strategjike zhvillimore në faqen 4 ku thuhet, po citoj, në bazë të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 Podujeva ka 88499 banorë, ndërsa në ueb faqen e Komunës së Podujevës ku për qytetarët, bizneset dhe investitorët e mundshëm potencial është qasja e parë për të marrë informacione, aty pasqyrohet si vijon, se Komuna i ka rreth 135000 banorë e që për kureshtjen e juaj nga burime zyrtare të Entit të Statistikave të Kosovës vlerësohet se në Komunën e Podujevës ekzistojnë 83242 banorë, pra ka një rënie prej 5257 banorë, pothuajse sikurse në gjithë Kosovën që ka rënie. Për të vazhduar tutje me një laramani në këtë dokument ku thuhet se janë 5322 biznese kurse në faqen zyrtare të Komunës ekzistojnë 3116 biznese, e njëjta gjë është edhe tek numri i nxënësve e kështu me radhë, por mos të harrojmë se sa e rëndësishme është që investitorëve potencial t'iu sigurohen informata përmbajtësore rreth numrit të saktë të të dhënave dhe informatave për t'i bindur ata për të investuar në Komunën tonë.

Në kuadër të këtij dokumenti pasqyrohet strategjia e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave ku tek deklarata e misionit të kësaj Drejtorie ndër të tjera thuhet, se kjo Drejtori informon lidhshin komunal me aktivitetin e ndërlidhur me buxhetin e Komunës, po e përsëris, aktivitetin e ndërlidhur me buxhetin e Komunës, ndërsa në bazë të të gjeturave të Auditorit të jashtëm tejkalojnë vlerën për ndërtimin e Bulevardit të famshëm tani të Komunës tonë ku vlera e tejkalimit kalon vlerën prej 70,818.00€, dhe kur pyeten nga Auditori i jashtëm për këtë çështje, përgjigja është kjo, kemi qenë konfuz, por unë uroj që mos të jeni të "pitë" herën tjetër kur të ktheni përgjigje.

Parafolësit japën sugjerime lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe unë nuk do t'i përsërisë ato por është e rëndësishme të potencohet se përmes këtij propozim buxheti nuk sigurohen as kushtet për zhvillim ekonomik lokal, Arsim e Shëndetësi. Ky buxhet i sjellë këtu për tu votuar kam përshtypjen se edhe sorrat që sillen për Podujevë e kanë kuptuar se është buxhet i asfaltit, por mos harroni se ky buxhet i asfaltit edhe për një kohë të gjatë do ta rëndoje buxhetin në vijim që do t'i ketë Komuna përmes intervenimeve për renovime të asfaltit se po të ishte shtruar njëherë e mirë dhe të mos ketë nevojë të paktën për 10 vite të intervenohet, atëherë hallall ju qoftë, por ne jemi dëshmitar se me çfarë cilësie punohet deri më tani.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim propozimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021/2023 të Komunës së Podujevës përfshirë rekomandimet nga mbledhja e KPF-së dhe kërkesën e drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financave për korrigjimin e një gabimi teknik.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 17 vota për, 8 vota kundër, 5 vota të përmbajtura, miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2021/2023 e Komunës së Podujevës, përfshirë Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së dhe korrigjimin e gabimit teknik, përkatësisht në faqen 9 të dokumentit, tabela nr. 3, rreshti nr.15 Arsimi kolona Staf, numri i lejuar që figuron 11462 të korrigjohet, dhe atë, 1462.

3. Raporti Financiar për periudhën janar – mars 2020

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth raportit financiar përkatës, ndër të tjera theksoi, qëllimi i këtij raporti është prezantimi i aktiviteteve financiare të zhvilluara gjatë periudhës janar-mars 2020, me theks të veçantë informatë të shkurtër lidhur me shpenzimet në nivel të organizatës buxhetore, shpenzime të cilat kanë ndodhur të ndara sipas kategorive ekonomike dhe sipas burimit prej nga këto shpenzime janë financuar duke krahasuar të gjitha llojet e shpenzimeve me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Shpenzimet e buxhetit për këtë periudhë raportuese kanë arritur në 3,427,592.00€ dhe atë; për paga dhe mëditje 2,935,137.00€, për mallra dhe shërbime 314,514.00€, për shpenzime komunale 84,002.00€, për subvencione dhe transfere 62,590.00€, për investime kapitale 31,329.00€, shprehur në përqindje 14.2% e buxhetit të planifikuar ose 2% më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Sa i përket realizimit të të hyrave vetanake përgjatë kësaj periudhe të cilat janë të paraqitura në tabelën 3 të të hyrave ku inkasimi i të hyrave për këtë periudhë është 314,226.00€ apo 22% e planit vjetor e që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kemi një zvogëlim të të hyrave prej 7%, e që ka pas një ndikim të menjëhershëm paraqitja e pandemisë nga data 15 mars ku zvogëlimi i të hyrave është reflektuar te tatimi në pronë dhe tek taksa për regjistrim të automjeteve. Për këtë periudhë kemi realizuar një donacion me Ambasadën e Japonisë për Shërbimin e Zjarrfikjes në vlerë prej 69,620.00€ për blerjen e një kamioni për nevojat e këtij shërbimi. Siç jeni të njoftuar viti fiskal 2020 ka filluar pa u miratuar buxheti për vitin aktual kështu që kemi filluar vitin me 1/12 të vitit 2019 për periudhën janar – mars, buxheti është miratuar më 19 mars 2020 dhe pas hyrjes në fuqi ka filluar së implementuari mirëpo kjo vonesë ka pas efekt negativ sidomos te investimet kapitale. Për fund mund të konstatoj se është një raport i cili jep një pasqyrë të shpenzimeve dhe të të hyrave për këtë periudhë raportuese.

z.Adnan Zymeri, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të nga radhët e LDK-së e mbështesim këtë raport financiar për periudhën janar-mars 2020 mirëpo duke kërkuar kujdes të shtuar nga Ekzekutivi i Komunës në periudhat e ardhshme raportuese për kategorinë e investimeve kapitale mirëpo duke qenë të vetëdijshëm për atë që e ceku edhe drejtori parafolës se ka pas vonesa në miratimin e buxhetit dhe që ka ndikuar në inicimin e proceduarve të tenderimit e që normal se ndikojnë në ngritjen e shpenzimeve kapitale.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, vazhdimisht e themi se raportet financiare janë përgjegjësi kryesore e Komunës dhe shumë e rëndësishme për qytetarët mirëpo prap se prap që tri vite radhazi kemi të njëjtin raport për nga transparencë, qartësia dhe aspak llogaridhënës ndaj qytetarëve. Këtë vit kemi një buxhet prej 26,756,269.00€ ku për paga dhe mëditje janë planifikuar 13,929,991.00€ planifikim ky i cili do të ishte planifikuar saktë sepse margjina e gabimeve për paga dhe mëditje është shumë e vogël por që edhe këtu duket se do të teproj buxhet sepse deri më tani janë shpenzuar 2,935,137.00€ apo rreth 20% e shumës totale, pra diçka që do të duhej të ishte shumë e saktë ju e bëni të pasaktë. Për subvencione dhe transfere janë planifikuar 660,000.00€ dhe deri më tani janë shpenzuar rreth 62,000.00€ pra ka pas rritje nga viti paraprak prej rreth 55% për subvencione në këtë periudhë por kjo nuk është për tu çuditur për shkak se kemi qenë në proces zgjedhor dhe jeni munduar që me subvencione t'i lajthitni qytetarët. Pastaj te investimet kapitale kemi një çudi të madhe, nga 9,432.455.00€ janë shpenzuar vetëm 31,329.00€ ose 0.5% e buxhetit për investime kapitale. Ne të gjithë jemi dëshmitar të tepërimit të buxhetit vit për vit kur çdo gjë ka qenë në rregull por që juve edhe në kushte normale ju ka tepruar buxhet, ndërsa tani e dimë që edhe periudha e pandemisë do të ketë suficit të pashmangshëm. Në total të buxhetit deri më tani janë shpenzuar rreth 12%, tek shpenzimet sipas kodeve do të përmendja vetëm shpenzimet enorme të Gjykatat pra shpenzimet për vendimet gjyqësore që janë 73,942.95€ në tremujorin e parë të vitit e që krahasuar me vitin e kaluar që ishte 1,869.00€ andaj ky lloj i shpenzimeve tregon jo efikasitet të Komunës në punë dhe diçka po fshihet prapa kësaj, e ka po fshihet e kam cekë edhe në seancën e kaluar dhe e dini më së miri ju. Sa i përket inkasimit të të hyrave edhe aty vërehen parregullsi, shembull, licencat komerciale të bizneseve po vërehet trendi i rënies nga viti 2019 ku nga 14,000.00€ sa ishte tani është rreth 3,500.00€ në vitin 2020 apo rreth 75% ulje e tregon edhe sa do të jetë për tre muajt përcjellës ku sigurisht se do të ketë shumë ulje ose nuk do të ketë fare për shkak të pandemisë, pra në tremujorin e parë ku pothuajse gjithçka ishte në rregull nuk ka pasë interesim për leje të bizneseve në Podujevë. Mandej edhe te taksat e pronës gjithashtu ka rënie të të hyrave ku nga 109,622.00€ në 94,700.00€, pra e dimë që në tremujorin e parë të vitit vetëm 15 ditë ishte pandemi por që trendi do të duhej të ishte në rritje në inkasimin e pronave ose do të ishte i barabartë me vitin e kaluar. Trajtim jo i mirë i donatorëve ka bërë që të hyrat e donatorëve për periudhën e njëjtë me vitin e kaluar të kenë rënie rreth 52%.

Në këtë raport kemi vërejtur edhe mos realizim të buxhetit, por patjetër duhet theksuar se kjo qeverisje është si një fjalë e urtë popullore “hyp se t'vrava zhdryp se t'vrava” për shkak se nëse investojnë i kemi dy raste të tenderëve, njëri për pakon e pandemisë ku nga 3 mijë biznese llapjane nuk ka aplikuar asnjë për këto pako ushqimore mirëpo ka aplikuar operatori nga Graçanica me qëllim të plotësimit të vendit që të fitoj tenderin operatori ekonomik “Beni Dona”. Pra kemi edhe tenderë furnizimi me sistem të ujitjes pikë-pikë dhe pajisje për kultivimin e mjedrës ku janë eliminuar 3 operator ekonomik shumë të lirë sepse janë kërkuar certifikata të ISO standardit e të cilat nuk lidhen aspak me atë që janë shpallur mirëpo kanë dashur që operatori i tyre me çmim më të lartë të fitoj gjithsesi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, lidhur me raportin financiar tremujor edhe pse drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave nuk ishte në mbledhjen e KPF-së, tani në hyrje e dha sqarimin e tij, mirëpo mua më bërë përshtypje se për investime kapitale ishin të planifikuara mbi 9 milion euro kurse për këtë tremujor kemi vetëm 31,000.00€ të shpenzuara e që është një shumë as 0.01% ku prej gjithë këtyre projekteve dhe këtij buxheti vetëm një kanalizim që ishte në qytet nuk ka mjete tjera të shpenzuara. Për dreka zyrtare ishin rreth 3,000.00€ të shpenzuara dhe për vendime gjyqësore ishin mbi 73,000.00€ që tejkalon trefishin e shpenzimeve nga vendimet gjyqësore dhe gjobat e taksës që është 0.8% në bazë të kamatës si dhe shpenzimet i tejkalojnë drekat zyrtare tejkalojnë këto investime që janë bërë dhe kjo tregon një mos efikasitet total i cili nuk përmbush parashikimet edhe të vetë Drejtorisë së caktuar dhe gjithë Ekzekutivit të Komunës i cili ka paraparë të ecë sipas planifikimeve të veta buxhetore.

Më bëri përshtypje edhe shuma 4,928.00€ për mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve zyrtare, do të thotë është një shumë marramendëse, ndërkohë i dimë edhe lëvizjet zyrtare në këtë kohë dhe faktikisht në këtë tremujor edhe stafi i Komunës ka qenë i reduktuar dhe ka punuar me kapacitete jo të plota të personelit administrativ ku shumë shërbime nuk janë kryer. Andaj për servisimin e automjeteve mendoj se secili subjekt politik duhet të kërkoj një gjë të tillë e që unë tani po e kërkoj nga personi kompetent se në cilin servis dërgohen për servisim automjetet e Komunës dhe cilat janë ato automjete që janë servisuar, pra unë po kërkoj këtë përgjigje nga Nënkrjetar i Komunës dhe nga drejtori i Drejtorisë së Administratës edhe pse që të dy nuk janë prezent këtu sot, pra duhet të njoftohemi ne se ku kanë shkuar rreth 5 mijë euro për servisim. Nëse Kryesuesi i Kuvendit nuk ka automjet personal të Komunës, nëse bëhet servisimi vetëm në letra i automjeteve, nëse ndërrohen gomat e qohen vetura private, nuk do të lejohet një gjë e tillë. Kam vërejtur edhe një shumë të mjeteve të shpenzuara 995.00€ qira për makineri, unë nuk e di çfarë qiraje është kjo a keni marrë me qira ndonjë makinë apo ndoshta paguani ndonjë stok për ndonjë makineri që e keni lënë ndokund në ndonjë autopark andaj është mirë të na sqaroni këtë shumë. Nuk po dëshiroj të hyjë më në detaje sepse jam në dijeni se pandemia paksa e ka stagnuar hapin e investimeve kapitale dhe për këtë jam shumë i vetëdijshëm por nuk jam që ky ritëm i suficitit të vazhdoj nga granti buxhetor dhe në fund të jetë shumë i madh përkatësisht nuk jam që të teprojnë milionat ndërsa në anën tjetër jemi në dijeni për nevojat që kemi si Komunë.

Kemi një shpenzim prej 3,000.00€ për dreka zyrtare në këtë periudhë pandemike ku gjitha kanë qenë të mbyllura të gjitha lokalet ushqimore dhe nuk ka funksionuar askush kurse kemi këtë shumë që është paguar prej 3 mijë euro e që po të llogaritim i bie se janë që mbi 100 persona duke llogaritur mesataren e racionit të kostos së shërbimit në Podujevë. Pra pyes dhe pres përgjigje, ku janë ngrënë këto dreka kur lokalet kanë qenë të mbyllura dhe nuk ka funksionuar asnjë lokal sepse ka qenë vendim qeveritar dhe i zbatueshëm edhe në Komunën tonë, kush i ka ngrënë këto dreka, por jo nëse kanë ngrënë në shtëpi kurse e faturon në Komunë e që do të ishte shumë gjë jo morale. Pra janë pyetje konkrete dhe pres përgjigje nga kompetentët, jo nga të tjerët. Pastaj si mendoni që me 0.01% shpenzime për investime kapitale deri më tani, të shfrytëzoni për pjesën e mbetur të vitit rreth 9 milion euro për këtë kategori. Mandej kërkoj përgjigje për drekat zyrtare, ku dhe kush ka qenë në dreka zyrtare, qëllimin e takimit.

Vendimet gjyqësore në shumë 73,000.00€, për cilin subjekt politik dhe cili është qëllimi që është dashtë që përmes gjykatës të tërhiqen mjetet. Servisimi i automjeteve zyrtare ku bëhet dhe cilat automjete janë servisuar duke përfshirë edhe arsyen e servisimit përkatësisht shpenzimin e 5000€, një servis i automjetit në 10000 km, i këtyre automjeteve zyrtare që posedon Komuna e Podujevës maksimumi i një servisi kushton 52 euro, po e përjashtoj këtë shumë dhe po e rrisë në 70-80 euro, por na tregoni sa automjete i keni servisuar dhe ku janë servisuar. Pastaj edhe pyetja

tjetër për qiranë për makineri shpenzim 1000€, për çka paguhet kjo qira. Pra këto ishin pyetje konkrete për të cilat kërkoj përgjigje sepse unë nuk kam mund të gjej element në këtë dokument të raportit financiar, andaj edhe kërkoj përgjigje.

z.Adnan Zymeri, theksoi, vlerësimi im i mëparshëm ishte vlerësim në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, mirëpo ajo që dëgjova nga parafolësit ishin të njëjtat fjalë të mëparshme të tyre si, mungesë e transparencës, llogaridhënies, praseprap profesionet e njëjta sikurse në seancën e kaluar si në këtë seancë, por praseprap LDK qeveris me Podujevën që 20 vite edhe praseprap do ta kemi opozitën e njëjtë të paktën deri në vitin 2035 ose 2037.

z.Blerim Maqastena, theksoi, kërkoj vetëm një sqarim prej drejtorit, edhe pse ka shumë gjëra tjera për sqarime por që njëra më bëri përshtypje paksa më shumë, fjala është për subvencione për entitete jo publike në shumë 21,926.00€ njëri shpenzim, kurse tjetri shpenzim për këtë çështje 23,190.00€, a ka mundësi të na sqaroni çka është ky kod i subvencioneve për entitete jo publike. Po ashtu edhe kodin për paga për përfituesit individual.

z.Avni Fetahu, theksoi, lidhur me raportin financiar u potencuan disa elemente shumë me rëndësi nga këshilltarja kolege znj.Doruntina Hasani. Unë do t'i pasqyroj disa çështje lidhur me këtë raport financiar për periudhën tremujore i sjellur në Kuvend me këtë përmbajtje aktuale e që nuk i përmbushë kriteret ligjore të një organizate buxhetore siç është Komuna. Ky raport përmban vetëm shuma totale të shpenzimeve për kategori të ndryshme ekonomike dhe në asnjë faqe nuk përfshihen detajet e lidhura me shpenzimet e parasë publike gjatë periudhës raportuese, tani do të paraqes një element shumë me rëndësi se si kamuflohet paraja publike këtu por paraprakisht kërkoj vëmendje dhe mos bisedim mes vete të këshilltarëve koleg.

Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, raportet tremujore përveç tjerash duhet të përmbajnë një përmbledhje të statusit të të gjitha projekteve kapitale dhe të shpenzimeve, mbishkrim të ndonjë suficidi ose deficidi buxhetor dhe mënyra se si janë financuar projektet, detajet e pagesave, borgjeve ndaj palëve të tjera e kështu me radhë, gjithashtu në nenin 2, paragrafi 2.1 të këtij Ligji, ndër të tjera sqarohet shumë qartë se paratë publike do të thotë paratë ose pasuritë financiare të cilat pranohen, janë nën përkujdesje, mbahen në mirëbesim në këtë rast të Komunës, kurse shtrohet pyetja tek ne, në ç'farë mirëbesimi po mbahet kjo para publike dhe si po shpenzohet kjo, jemi dëshmitarë të gjithë se si menaxheri i prokurimit shndërrohet në një "tuxhar" tenderësh duke eliminuar operator ekonomik dhe duke i shkaktuar buxhetit humbje, duke i zhgënjyer në mënyrë totale operatorët ekonomik dhe t'i tërhejk prej projekteve komunale, të njëjtën kohë edhe duke i larguar bizneset që të orientohen në Komuna të tjera. Unë e kuptoj që këto që po i them edhe mund t'i pengojnë dikujt, për ata edhe më keni dërguar edhe njerëz kështu që unë po ju tregoj nga këtu se unë frikën nuk ja kam askujt, nuk kam asgjë personale as me Nënkryetarin e Komunës, as me ish Kryetarin, as me menaxherin e prokurimit por unë i mbrojë parimet e mia kur e shohë se është duke u dëmtuar buxheti para syve tanë dhe para syve të qytetarëve tanë. është shumë me rëndësi t'juja potencoj një njoftim të një kontrate të caktuar, shikoni, këta edhe në shkollë janë në gjendje të kamuflojnë paranë publike, bëhet fjalë për shkollën "Dituria" në fshatin Llapashticë e Poshtme dhe në të njëjtën kohë edhe shkollën "Elfir Behrami" në fshatin Metehi ku është për punë shtesë, për ta kuptuar më thjeshtë se si këta i kamuflojnë mjetet financiare dhe e sjellin raportin financiar, shikojeni rastin konkret, njëherë i eliminojnë operatorët e përgjegjshëm, mënyrën si i eliminojnë këta është shumë thjeshtë, ju kanë dhënë punë shtesë një operatori ekonomik dhe po e citoj me emër në mënyrë që ta ketë të kjartë edhe prokuroria në të ardhmen, kompania "Prishtina" Sh.p.k., kësaj kompanie në fund të vitit i jepet shtesë 10% në vlerë të kontratës e që kapë shumën 41,113.32€, pse i jepet punë shtesë kësaj kompanie kur ekziston projekti zbatues, në projekt zbatues duhet të parashihen të

gjitha specifikat, shkolla nuk ndërtohet për herë të parë dhe nuk është ai që ka ndërtuar për herë të parë shkolla, do të thotë ka ndërtuar edhe shkolla tjera. Përveç kësaj kemi informacione të sakta ku kompania “Prishtina” Sh.p.k. është shpallë fituese pa i plotësuar kushtet ku brenda një pozicioni të paramasës të atij projekti nuk e ka vë çmimin fare, bëhet fjalë për suvatim, dhe tani ajo ka dal më e lirë dhe për ata ja kanë japë tenderin këta, tani për t’ia kompensuar këtë shkojnë me mjete shtesë prej 10% përkatësisht 41,113.32€ i japin për punë shtesë, pa pasur të drejtë, dhe në këtë formë i eliminojnë kompanitë që janë serioze, i fusin kompanitë që janë jo serioze dhe e dëmtojnë buxhetin, e dëmtojnë ekonominë e vendit lokal ku jemi dhe çka është më e keqja jau “gërditin” bizneseve të aplikojnë në projekte të rëndësishme që janë në Komunë. Pra këto janë vetëm disa prej tyre kurse të tjera do t’i dërgojmë aty ku duhet sepse ne e dimë se menaxherin e prokurimit atë “tuxharin” e tenderëve ju nuk mund ta shkarkoni sepse atë e ka ngarkuar ai “ishi” dhe ai është i interesuar ta mbajë ende aty sepse i vyen ashtu qysh i kanë vyer edhe shumë të tjerë por ne përmes organeve kompetente kemi me jau tregu vendin.

Kryesuesi i Kuvendit, i drejtohet parafolësit, theksoi, ju vetëm punoni dhe argumentoni por gjuha në foltore të jetë gjuhë tamam gjuhë, siç duhet të jetë, aq më tepër që je pedagog, andaj lëni ato shprehje si “tuxhar”, e gjëra të tilla, sepse nuk keni të drejtë ta quani askënd ashtu.

Pra unë po i referohem Rregullores së punës së Kuvendit, nuk lejohet gjuhë jo parlamentare. **z.Isuf Latifi**, drejtor i DBF, theksoi, do të bëjë përpjekje t’i sqaroj disa shqetësime që u ngritën, fillimisht rreth asaj që u cek se shpenzimi i pagave edhe nuk është planifikuar mirë por edhe nuk është shpenzuar mirë, planifikimi bëhet i saktë për punëtorët e lejuar të Komunës së Podujevës duke përfshirë të gjitha Drejtoritë, administratën komunale, arsimin, shëndetësinë e të tjera, numrin e lejuar të punëtorëve ku secili prej tyre e ka një koeficient në bazë të të cilit ne planifikojmë saktë shumën, pavarësisht sa mund të del në fund 13-14 milion, por shpenzimi ndodh vetëm për ata që kryejnë punë dhe të cilët gjatë periudhës përkatëse është në marrëdhënie pune, e them këtë sepse ndokush gjatë kësaj periudhe mund të vdes, mund të shkoj në pension, rekrutimi ka një procedurë dhe merr një kohë të caktuar dhe kështu mund të kaloj 1 apo 2 muaj që ndonjëri prej atij stafi nuk merr pagë, kështu që çdo herë do të ketë lëvizje në këtë aspekt, por si planifikim bëhet saktë për numrin e lejuar dhe në koeficientin e lejuar për secilin në bazë të kontratës mirëpo shpenzimi asnjëherë nuk mund të bëhet sipas planifikimit për arsyet që veç i ceka, prandaj e them se është mirë që po na mëson këshilltarja parafolëse se si të planifikojmë dhe si të shpenzojmë, por që ky është realiteti.

Çështja tjetër, shpenzimet e vendimeve gjyqësore, asgjë nuk jemi duke fsheh, të gjithë janë transparent me emër e mbiemër, të gjithë janë punëtor të arsimit dhe punëtor të shëndetësisë ku të gjithë po përfitojnë nga ato që ju kanë premtuar në fushata zgjedhore këtyre punëtorëve, të gjitha partitë politike, por këtu janë edhe emrat e atyre të cilët kanë nënshkruar kontrata kolektive kur kanë pretenduar të bëhen kryeministra dhe në bazë të atyre kontratave kolektive punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë tani janë duke i realizuar ato të drejta të shkruara në një dokument – kontratë kolektive të nënshkruar nga të paktën 3 persona, dhe nuk kemi çfarë të bëjmë ne këtu por vetëm duhet ta paguajmë sepse kanë marrë vendim gjyqësor, dhe janë të evidentuar me emër e mbiemër dhe nuk ka të tjerë dhe nuk fshihet asgjë këtu, nuk ka të tjerë përveç punëtorëve të arsimit dhe shëndetësisë, pra këtu i kam emrat e tyre dhe do të ketë edhe në tremujorin e dytë të vitit e ndoshta e në tremujorin e tretë të vitit sepse sipas informatave që kam tani janë minimum 1000 padi gjyqësore në arsim për shujta dhe për transport, dhe në bazë të atyre dokumenteve që ata po bazohen, jam i bindur se mbi 95% të gjithë do t’i realizojnë ato të drejta dhe të gjithë do të marrin para përmes vendimeve gjyqësore, shuma të cilat sërish do t’ju sjellën në këtë Kuvend sepse është obligim i Ministrisë së financave t’i ekzekutoj ato vendime, por jo Drejtoria e

Buxhetit dhe Financave e Komunës së Podujevës sepse ne vetëm e paraqesim para Kuvendit si shpenzime sipas vendimeve gjyqësore, por nëse ju duhen emrat dhe mbiemrat unë këtu i kam dhe mund t'ju tregoj, andaj të mos thuhet po fshehët diçka këtu sepse është financë publike dhe nëse unë si drejtor e fshehë nuk do ta fsheh Ministria e Financave e cila është e obliguar që çdo kush që i drejtohet me shkrim për ndonjë shpenzim ajo ia jap.

Tek servisimi i automjeteve, kompania e cila bënë servisimin e automjeteve zyrtare të komunës është “Luli” - Gllmanik e cila i servison të gjitha automjetet e Komunës, të QKMF-së dhe Njesisë së Zjarrfikësve e që janë mbi 40 automjete që servisohe.

Gjithashtu u cek edhe shpenzimi për qira për makineri, pas aksidentit që ka pasë Kryetari i Komunës z.Agim Veliu, e ka marrë prej Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik – OSHP një automjet me qira të cilin e ka shfrytëzuar deri në momentin sa ka qenë Kryetar Komune andaj edhe është dashtë të paguhet në formë të qirasë sipas kontratës të cilën e ka bërë OSHP-ja, automjeti është marrë prej Kuvendit të Kosovës ku ka qenë i lirë dhe është marrë në shfrytëzim.

Subvencionet për entitete jo publike, mund t'ju sqaroj se entitet publik është Teatri i Qytetit dhe ndonjë organizatë tjetër e ngjashme që merr subvencione, ndërsa të gjitha tjerat janë jo publike dhe ai kod është për organizata jo publike të cilat janë me status jo publik. Pastaj pagesa për përfitues individual, zakonisht janë mjete buxhetore për persona në nevojë kryesisht atyre me gjendje të rëndë shëndetësore me sëmundje kronike të cilëve ju jepen kohë pas kohe prej 50€ deri në 300€ si shumë momentale, varësisht prej diagnozës, por që figurojnë si pagesa individuale. Mandej u ngritë edhe çështja e shpenzimeve për dreka zyrtare gjatë periudhës tremujore, pandemi ka filluar më 15 mars 2020 kur janë marrë masa, janë mbyll lokalet etj etj, pra këtu kemi të bëjmë vetëm për 15 ditë, kurse deri më këtë datë gjithçka ka qenë normale qoftë për dreka, qoftë për pritje të mysafirëve dhe të bëhen shpenzime dhe gjatë asaj periudhe kanë qenë mysafir disa të rinj nga Gjermania të cilët e kanë vizituar Komunën e Podujevës së bashku me disa zyrtar të një Qyteti të Gjermanisë me të cilin Komuna e Podujevës është e Binjakëzuar, dhe sigurisht që ata mysafir është dashtë të priten dhe t'iu shtrohet një dark ose drek gjatë kohës sa ata kanë qëndruar për vizitë në Komunën e Podujevës.

E përsërisë, entitete janë gjitha tjerat përveç atyre që kanë status publik siç është Teatri i Qytetit dhe ndonjë organizatë tjetër n'kuadër të Komunës, shembull, Kompania “Pastrimi” që Komuna është aksionare ose ndonjë kompani tjetër publike, ndërsa gjitha tjerat sikurse që është Bashkësia Islame, ndonjë OJQ dhe gjitha të tjerat me status jo publik janë entitete jo publike

znj.Doruntina Hasani, theksoi, drejtori parafolës u mundua të paraqitet kinse unë jam këtu dhe nuk ka tjetër, mirëpo i nderuar drejtor i DBF ne të gjithë dimë të llogarisim kështu që po ju tregoj, janë të planifikuara 13,929,991.00€ për këtë vit, deri tani janë shpenzuar 2,935,137.00€, e që do të thotë se nëse vazhdohet me këtë trend, do t'ju teprojnë 2,189,443.00€, andaj a e dini sa është shumë e madhe buxhetore nëse tepron kjo shumë. Margjina e gabimeve për paga dhe mëditje, kur të llogaritet është shumë e vogël dhe sigurisht jeni në dijeni se në vitin 2019 kanë qenë 12,142,542.00€ ndërsa për këtë kohë janë shpenzuar 2,971,373.00€ që do të thotë se është e njëjtë ashtu sikurse që është shpenzuar në vitin 2019 por e ceka se ka rritje të shumës për paga dhe mëditje, e që mund të them se ky është një mos planifikim.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, dëshiroj të cek edhe një gjë të cilën ndoshta e harrova ta cek paraprakisht, planifikimi i vitit 2020 për paga dhe mëditje ka qenë planifikim sipas Ligjit për paga e që është mbi 1 milion euro kostoja nëse do të fillonte së implementuari në këtë vit, dhe ai planifikim është pjesë e këtij planifikimi dhe këtij miratimi në buxhet por që tani Ministria e Financave përkatësisht ish Ministri në pajtim me Kryetarët e Komunave ka bërë llogaritjen për secilën organizatë buxhetore sa ka qenë planifikimi për zbatim të Ligjit për paga dhe pastaj me

ligj e ka ndarë dhe ka vënë në rezervë për secilën Komunë veç e veç, pra nuk e ka marrë por e ka ndarë n'kuadër të buxhetit të secilës Komunë në mënyrë që në rast se fillon së implementuari Ligji në fjalë ajo rezervë kthehet në kategorinë paga dhe mëditje dhe pastaj punëtorët do të marrin pagat sipas Ligjit të ri për paga, nëse nuk ndodh implementimi për shkak se gjendet në Gjykatë Kushtetuese, atëherë do të lëshohet një dokument sipas të cilit do t'ju thuhet Komunave që atë pjesë të buxhetit që keni planifikuar për paga, ku keni nevojë ju të planifikoni urdhëroni propozojeni në Kuvendet Komunale, miratojeni, sjelleni në Ministri dhe pastaj vazhdoni tutje.

Pra kjo është çështje politike të cilën nuk mund t'ia saktësoj parafolëses se kështu ka ndodh, por kjo është realitet andaj nuk do të thotë se gjithçka këtu e din këshilltarja në fjalë, ndërsa në anën tjetër na thotë neve, nuk dini, e që jam i bindur se dimë pak më shumë se ju e nderuar Doruntinë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, po nisem prej kësaj të fundi që e potencoi drejtori parafolës dhe këtu është faji që ju vetëm lexon dhe nuk jeni në gjendje të komunikoni dhe të sqaroni çdo çështje dhe ta kemi të qartë të gjithë, do të thotë që shkathtësinë me publikun e ke zero drejtor sepse nuk dinë tjetër përveç që të lexosh.

Tek shpenzimet gjyqësore drejtori i DBF nuk ishte në gjendje të tregon sa ka shpenzuar për punëtorin që padrejhtësisht e keni larguar nga puna dhe e cila me procedura gjyqësore është rikthyer. Çështja tjetër është se as vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Publik nuk i keni ekzekutuar, fjala është për Shukrije Zhitia dhe Hanëmshahe Berisha, që edhe më parë i kam cekë, a ju brenë ndërgjegjja juve që me të gjitha vendimet, në të gjitha shkallët gjyqësore me vendim fuqplotë ju nuk jeni në gjendje ta ktheni në punë, është e turpshme për ju, madje nuk e keni përjashtuar për shkaqe të shkeljeve as të kodit të mirësjelljes por e keni përjashtuar vetëm për shkak të përkatësisë politike sepse ka qenë simpatizante apo anëtare e PDK-së, por që nuk është me rëndësi, por është me rëndësi shkelja e të drejtave themelore apo elementare të njeriut, posaçërisht një femre, kështu që mos e përziej shumë me konkurse, me punësime por trego gabimet që i bëni. Pastaj, ju e mbani në të njëjtin pozicion menaxherin apo udhëheqësin e personelit kur jeni në dijeni se me aktgjykim është shpallë fajtor dhe kur shpallet fajtor jeni në dijeni se të njëjtit i ndërpritet marrëdhënia e punës, ose duhet që institucioni të formoj komision disiplinor, të shikoj aktgjykimin se a kanë të bëjnë ato shkeleje që ai ka ra ndesh me ligjin me punën apo lidhur me punën, mund ta degradoj, mund t'i shqiptoj një masë dhe rishkarkim, dhe unë pyes çka është bërë në këtë rast, pra nëse ju keni qëndrime të gabuara dhe të paligjshme ndaj qëndrimeve gjyqësore dhe ndaj ligjit, atëherë unë mendoj se gabime keni shumë por po përpiqeni të maskoheni dhe t'i thoni gjërat ashtu siç e keni zakon sepse ndryshe nuk dini, ndërsa për planifikim të dobët jeni, sinqerisht jua them këtë sepse vetëm sheshin po e marrim shembull në janar e filluat kurse që gjashtë muaj jemi aty ku jemi në atë gjendje, pra nuk jeni të hapur dhe nuk jeni transparent.

z.Hasan Ajeti, theksoi, nuk është shumë etike të jepen kualifikime me emra të përveçëm.

Sa i përket asaj që e tha parafolësi për shefin e personelit të Komunës së Podujevës, sa unë jam në dijeni udhëheqës i personelit është z.Fitim Bunjaku për të cilin nuk e di se ai ka diçka ndesh me ligjin apo me ndonjë gjykatë, kurse sa i përket gjërave tjera unë mendoj se është mirë të jepen vërejtje dhe kritika por gjithnjë duke mos e kaluar raportin e etiketimit të personave, pra është e papranueshme të jepen kualifikime për emra të përveçëm. Të gjitha çka u kërkuan i sqaroj drejtori i DBF, mirëpo nuk është krejt zi ashtu siç po thuhet këtu nga disa të cilët po mundohen të na mbajnë ligjëratat puro politike duke thënë vlerësuar krejt keq keq, mirëpo krejt zi apo keq nuk është ka vend për vërejtje ka vend për kritika dhe gjëra të ngjashme, por jo ashtu.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës dhe kalojmë në pikat e radhës.

4. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare (subvencionimi i ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet në gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit)

z.Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse (meqë Nënkyetari i Komunës dhe drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale janë në takim zyrtar) ndër të tjera theksoi, lidhur me këtë propozim vendim kemi të bëjmë me ndarjen e mjeteve financiare përkatësisht jeni të informuar se javën e kaluar është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi mes Nënkyetarit të Komunës së Podujevës dhe përfaqësuesit të shoqatën Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” nga e cila kemi një ndihmë për ndërtimin e 26 shtëpive për familjet në nevojë në Komunën e Podujevës, e që ne si Komunë për këtë bashkëfinancim marrim pjesë me 130,000.00€.

Përndryshe kemi të bëjmë me një projekt jashtëzakonisht të mirë sipas të cilit do të ndërtohen 26 shtëpi banimi për familjet në nevojë me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit. Përveç këtyre edhe 22 shtëpi veç i kemi proceduar dhe janë duke u ndërtuar në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc. Pra është një mundësi e mirë për t’iu ndihmuar familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit.

z.Bunjamin Hoti, theksoi, një ndër punët shumë të mira që unë vlerësoj që është duke u bërë është edhe kjo lidhur me trajtimin e personave që kanë probleme me banim dhe që nuk mund të kenë një banim të përballueshëm. N’kuadër të këtij aktiviteti është nënshkruar edhe një Memorandum Bashkëpunimi siç e ceku edhe drejtori parafolës dhe që ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështesim që këto mjete financiare të ndahen në mënyrë që të ndërtohen ato shtëpi të parapara në Memorandumin e Bashkëpunimit mes Organizatës gjegjëse dhe Komunës së Podujevës.

z.Vendenis Lahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së shprehim mbështetje për këtë pikë të rendit të ditës për ndarjen e mjeteve për ndërtimin e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve. Le të bëhet kjo punë dhe të kryhet sepse vitin e kaluar ka humbur grandit qeveritar dhe nuk është arrit të vazhdoj procesi për ndërtimin e tyre kështu që mos të ndodh që edhe në këtë vit të mbesim pa ato shtëpi të reja. Kështu që e mbështesim.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve të PDK-së e mbështet këtë projekt për të cilin mendojmë që është projekt mjaft i mirë dhe do të mbështesim edhe në të ardhmen projekte të tilla të mira që janë për Komunën tonë dhe për njerëzit e saj.

z.Patriot Rudari, theksoi, edhe ne nga radhët e AAK-së e mbështesim këtë projekt dhe gjitha ato që janë në të mirën e Llapit do t’i mbështesim edhe në të ardhmen.

z.Hamdi Jaha, drejtor i DPUMM, sqarim shtesë, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim kemi të bëjmë me ndërtime të shtëpive jashtë Lagjes së Dëshmorëve, pra për familje me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit. Madje nëse këtë vit arrijmë ta implementojmë mirë këtë projekt për ndërtimin e 26 shtëpive në bashkëfinancim me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit”, vitin e ardhshëm do të kemi mundësi që të fillojmë edhe me ndërtimin e 50 shtëpive tjera, natyrisht edhe nëse ndajmë buxhet si Komunë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, po vërehet se të gjithë e përkrahin këtë propozim vendim dhe nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, andaj e hedh në votim propozim vendimin për ndarjen e mjeteve financiare që për qëllim ka subvencionimin e ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet në gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit, sipas materialit të prezantuar në mbledhjen e KPF-së mbajtur një ditë më parë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se njëzëri nga të pranishmit miratohet propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare sipas materialit përkatës.

5. Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë kemi të bëjmë me ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht zëvendësimin e dy anëtarëve të këtij Komiteti të cilët kanë janë zgjedh Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës si dhe duke përfshirë edhe tërheqjen me vetë dëshirë të anëtarit z.Avni Fetahu nga pozita e anëtarit të KPF-së, andaj të deklarohen dhe njëkohësisht të jepen propozimet e anëtarëve të rinj nga Grupet përkatëse të këshilltarëve të subjekteve përkatëse politike.

z.Hasan Ajeti, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, e propozojmë z.Patriot Rudari në vend të anëtarit të dorëhequr nga përbërja e KPF-së. Këtë duke respektuar edhe Udhëzimin Administrativ sipas të cilit çdo subjekt politik duhet të përfaqësohet në KPF.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, do të thotë z.Patriot Rudari propozohet anëtar në KPF në vend të z.Avni Fetahu i cili me vetëdëshirë dorëhiqet nga të qenit anëtar në këtë Komitet.

z.Bajram Ajeti, theksoi, siç edhe jeni në dijeni Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së deri në zgjedhjet parlamentare ka pas z.Fitim Hazirin i cili edhe ka qenë kryesues i Grupit të këshilltarëve të LVV-së por meqë ai ka marrë pozicionin Deputet i Parlamentit të Kosovës, mirëpo tani kryesues të Grupit e kemi z.Vendenis Lahu i cili edhe propozohet anëtar në Komitetin për Politikë dhe Financa.

z.Fatmir Rudari, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së qëndrojmë prapa propozimit të bërë në mbledhjen e kaluar, përkatësisht znj.Endritë Murati propozohet në vend të ish anëtares së KPF-së znj.Floretë Zejnullahu tani Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Njëherit, publikisht nga kjo foltore falënderoj z.Avni Fetahun për zhbllokimin e kësaj çështjeje, praktikë e cila nuk ka ndodh më herët sa unë jam pjesë e këtij Kuvendi sepse edhe kur kanë lëvizur këshilltarët e Kuvendit nga një subjekt në tjetrin ose që kanë dal të pavarur, pozitën e anëtarit të KPF-së e kanë mbajtur mirëpo zotëri Fetahu me dorëheqjen e tij nga të qenurit anëtar në KPF e bëri një gjeste shumë të mirë për çka e falënderoj publikisht.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pra kemi propozimet përkatëse nga tri Grupet e këshilltarëve të Kuvendit, andaj e vë në votim ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa sipas propozimeve përkatëse duke përfshirë edhe dorëheqjen e z.Avni Fetahut nga pozita e anëtarit në këtë Komitet.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet ndryshimi dhe plotësimi i përbërjes së komitetit për Politikë dhe Financa, dhe atë;

z.Patriot Rudari caktohet në vend të z.Avni Fetahu i cili tërhiqet nga pozita e anëtarit të KPF-së,

z.Vendenis Lahu caktohet në vend të z.Fitim Haziri i cili është zgjedhë Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

znj.Endritë Murati caktohet në vend të znj.Floretë Zejnullahu e cila është zgjedhë Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës

6. Kërkesa / peticioni i një numri të pronarëve të dyqaneve ushqimore të fshatit Orllan për lejimin e punës edhe ditëve të dielave gjatë periudhës verore (ose me mundësi të zëvendësimit me një ditë tjetër të javës)

z.Hasan Ajeti, theksoi, si pikë e rendit të ditës pra hyri edhe kjo kërkesë për ndryshimin e ditës së pushimit për dyqanet ushqimore e cila i referohet regjionit të Orllanit, kërkesë e cila besoj që të gjithë shefave të Grupeve të subjekteve të Kuvendit dhe Kryesuesit të Kuvendit ju ka dërguar sipas së cilës kërkohet vetëm të bëhet zëvendësimi i ditës së pushimit, do të thotë, kërkohet që dita e dielë të jetë ditë pune për shkak të specifikave që ka ai lokalitet dhe të zëvendësohet me një ditë tjetër.

Ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së në parim jemi të pajtimi por që gjithmonë duke respektuar procedurën ligjore sepse fundja ne jemi në dijeni se kemi një Rregullore komunale e cila është në fuqi dhe jemi në dijeni për procedurat kur bëhet ndryshimi dhe plotësimi i çdo dispozite të asaj Rregulloreje, mirëpo një gjë duhet ta kemi parasysh se nuk guxojmë të ngutemi dhe të marrim ndonjë vendim të ngutshëm që nesër ata banorë të cilët zhvillojnë këtë biznes, e që sipas kërkesës janë të paktën 4 dyqane të tilla, dhe për ato 4 biznese duhet të shikohet edhe baza ligjore.

Ne tani kemi edhe shkresa tjera nga subjektet që janë në qendër të qytetit dhe në lokalitete të ndryshme të fshatrave ku ata kërkojnë që në gjithë territorin e Komunës së Podujevës të respektohet Rregullorja në fjalë, prandaj dëshiroj të them se jemi në një pozicion që duhet pasur shumë kujdes, mirëpo ajo që është parimore mendoj se duhet të shikohet aspekti procedural juridik për shkak se nëse ne shkojmë me një veprim të tillë atëherë gjykoj se një akt i tillë mund të mos ketë ndonjë efekt edhe përkundër asaj që mund të votohet nga ana jonë si Kuvend i Komunës. Si do që të jetë unë e thash dhe po e përsërisë që në parim e respektojmë dhe e mbështesim këtë kërkesë por gjithnjë duke respektuar bazën ligjore. Pra në bazë të shkresës që unë e posedoj kemi të bëjmë me 4 biznese të komunitetit të Orllanit, por që jam i mendimit se fillimisht duhet të trajtohet në aspektin procedural.

z.Vendenis Lahu, theksoi, sa i përket kësaj çështjeje ne e kemi parasysh që mund të ngritën konflikte interesash por do ta kemi po ashtu parasysh prej subjekteve që janë në zona tjera në Komunën tonë, por ne kemi edhe një Strategji të Zhvillimit të Turizmit dhe një Strategji të Zhvillimit Ekonomik Lokal kështu që besoj se atributet e secilës zonë duhet pasur parasysh sepse unë mendoj dhe besoj se pajtohem të gjithë që është anti strategjike mos funksionimi i bizneseve në një zonë turistike ditën e dielë siç është Orllani, mirëpo mendoj se duhet të gjejmë një zgjidhje për këtë çështje, pse jo ndoshta ta votojmë sot. Për bazë ligjore ndoshta nuk mund të foli sot me kompetencë të madhe por që besoj se juristët janë më kompetent dhe mund të japin një pasqyrë më të qartë se si mund të realizohet kjo kërkesë, mirëpo për mendimin tim po, pse jo, ndërsa në rast se nuk është me bazë ligjore atëherë Ministra përkatëse e kthen mbrapa. Pra ne bashkërisht mund të marrim këtë vendim dhe nuk është që dikush mund të dëmtohet, por që mendoj se në këtë periudhë verore që tani ka filluar mund të dëmtohen shumë lokaliteti i Orllanit nëse vazhdon të jetë ditë pushimi dita e dielë e që është dita më e papërshtatshme për ato dyqane dhe është e vetmja ditë që ata nuk dëshirojnë të mos punojnë është dita e dielë sepse ndoshta vetëm ditëve të vikendit ata bëjnë qarkullim sa krejt ditët tjera të javës, madje mendoj se duhet ta marrim pak më me prioritet këtë çështje ngase në rast se presim procedurat ato mund të zgjaten dhe të vonohen.

Gjithsesi vendimin që mund ta marrim ne duhet pasur parasysh të drejtat e punëtorëve që të respektohen, mendoj se inspektorati ka mundësi dhe kapacitete për zbatimin e një vendimi të tillë të cilin ne e marrim.

Me gjithë respektin për zonat tjera por zonat me karakter turistik të Komunës tonë duhet të përshtatet edhe orari i punës sepse njerëzit shkojnë në ato zona kur kanë kohë të lirë, do të thotë pushimeve në vikende.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, e kuptoj se zona e Orllanit është specifike për vendin tonë dhe unë mendoj se duhet ta mbështesim, mirëpo për shkaqe të vështirësive që kanë hasur bizneset gjatë pandemisë do të thoja të mos dallohen edhe pjesa tjetër sidomos restorantet dhe marketet, edhe ashtu sa kam vërejtur disa po mundohen të punojnë “në të zezën” e që si duket inspektorati nuk po mund ta kryen punën aq sa duhet e që do të doja që inspektorati ta kryen strikt punën e vetë sa i përket orarit të punë së bizneseve si dhe po ashtu të respektohet Ligji për të drejtat e punëtorëve që ata ta kenë të paktën një ditë në javë pushim.

z.Hasan Ajeti, theksoi, besoj që ne që jemi nga fusha juridike jemi në dijeni për aspektin procedural, jemi këtu disa siç është edhe z.Bajram Ajeti i cili ka edhe përvojën e duhur. Është ky organ që e ka miratuar Rregulloren për orarin e punës së bizneseve dhe është po ky organ i cili duhet ta bëjë plotësim ndryshimin e asaj rregulloreje. Nuk mund të jetë Rregullorja siç e thotë populli “për dikë nënë, për dikë njerjë”, por kur vendosim diçka duhet të vendoset në vijë të përgjithshme, në rastin konkret sipas shkresës kemi të bëjmë me 4 biznese, madje biznese të vogla, në anën tjetër kemi edhe kërkesa tjera këtu në qytet që kërkohet respektimi i kësaj Rregulloreje, prandaj pa hy në çështje tjera profesionale unë mendoj që fillimisht duhet të shikohet dhe analizohet vetëm aspekti procedural ligjor, e jo të nxirret një akt i cili pastaj mund të na revokohet apo të mos ketë fuqi juridike. Madje për këtë çështje është Drejtoria përkatëse e cila ka qenë sponzorizuese e këtij akti e cila së bashku me zyrën ligjore und ta trajtojnë këtë çështje dhe në fund ne si organ ligjvënës mund ta shqyrtojmë dhe të votojmë. Pra mendoj se nuk është e thënë që ne sot të marrim një vendim të ngutshëm sepse sa kam lexuar dhe sa jam në dijeni nuk është në harmoni të plotë me procedurat që parasheh ligji.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj se proceduralisht vetëm një vendim mund ta marrim ne sot, përkatësisht ne si Kuvend mund të marrim vendim vetëm për ta shfuqizuar Rregulloren në fjalë ose të interferohet në pikën konkrete, vendim tjetër nuk mund të marrim sot sepse është jashtë çdo norme dhe procedure administrative. Ne kemi disponim të gjitha Grupet e këshilltarëve të Kuvendit, edhe pse disponimi u shpreh në fillim që kjo kërkesë të hyjë në rend të ditës, fillimisht Grupi i këshilltarëve të LDK-së sepse është drejtori i Drejtorisë përkatëse i cili e ka sjellë këtë Rregullore e cila sot është në fuqi, por që tani ai drejtor nuk është prezent këtu, pra nëse ju jeni të disponimit edhe ne jemi që të ndryshohet dhe plotësohet kjo Rregullore sa i përket zonës turistike në Orllan.

Kemi Kornizën Afatmesme Buxhetore e cila është sjellë ndryshe nga Plani zhvillimor, pra për tu marrë me një dokument duhet të lexohen edhe dokumente tjera, e them këtë sepse dikush vetëm po e ngritë dorën dhe po e ulë pa pasur informata të mjaftueshme lidhur me çështje të caktuara.

Rregullorja për orarin e bizneseve është votuar në këtë Kuvend unanimitet nga të gjithë ne sepse ka qenë kërkesë e një numri shumë të madh të bizneseve që drejtori i Drejtorisë përkatëse i ka prezantuar por që tani nuk është prezent për të dhënë mendimin e tij, mirëpo nëse si Grupe të Këshilltarëve duke përfshirë edhe Grupin e LDK-së është i pajtimit ne si Kuvend mund të marrim vendim sot që të bëhet plotësim ndryshimi i Rregullores ekzistuese, të ngritet një komision prej Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit duke përfshirë edhe nga Ekzekutivi, konkretisht edhe drejtori i Drejtorisë së planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, të analizohet pika – neni përkatës, të bëhet ai ndryshim dhe të publikohet në faqe zyrtare plotësim ndryshimi i Rregullores, kjo do ta lironte edhe inspektoratin komunal sepse ata janë në terren dhe duhet ta respektojnë Rregulloren në fjalë.

Nëse nuk keni disponim ta ndryshoni Rregulloren përkatëse, kot i ngrisim duart sepse është jo valide pastaj, nëse keni disponim mund të merreni vesh shefat e Grupeve, të formohet një komision, të bëhet plotësim ndryshimi.

z.Hasan Ajeti, theksoi, unë e ceka edhe në fillim se në parim e mbështesim dhe këtu nuk ka kurrfarë diskutimi, dhe shumë mirë e sqarova më parë, nuk është çështja se dikush është kundër e dikush për, mirëpo çështja ka të bëjë me aspektin procedural. Pra ne duhet ta respektojmë vetëm vijën

procedurale sepse kemi të bëjmë vetëm me një lokalitet të caktuar dhe tani sa na mundëson ligji mbetet ta shohim sepse nuk mund të themi asnjë këtu gjëra për mëndësh kemi apo nuk kemi të drejtë, mirëpo unë mbetem prapa qëndrimit që e bëra më parë se duhet vetëm të ndjekem procedurat. Përndryshe problemi më i vogël është që të formohet komision, madje nëse veç formohet unë tani e propozoj z.Bunjamin Hotin për anëtar, por problemi është çfarëdo që nxjerrët në jetë në harmoni me procedurat ligjore.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, mendoj që është mirë të ulen për pak qaste shefat e Grupeve të këshilltarëve, të diskutojnë dhe të dalin me një qëndrim të përbashkët rreth çështjeve të ngritura sepse është mirë që vendimmarrja të jetë unanime, çka do qoftë. Pra kërkoj që për 3-5 minuta të kemi një qëndrim të përbashkët prej Grupeve të këshilltarëve, kurse ne i ndalim punimet për 5 minuta deri sa përfaqësuesit e Grupeve të dalin me qëndrim. (*Kërkesë e cila u përkrash njëzëri*).

z.Bajram Ajeti, theksoi, pra ishim në takim të shkurtër përfaqësues të Grupeve të këshilltarëve (unë, z.Fatmir Rudari dhe z.Hasan Ajeti) dhe ne u morëm vesh. Është e vërtetë se aktet administrative siç janë edhe rregulloret është një procedurë e veçantë e miratimit të tyre por edhe plotësim ndryshimit të tyre, kështu që me një kusht që ne sot ta formojmë një komision i cili duhet të jetë tepër efektiv dhe për një kohë shumë të shkurtër, madje për hir të burimeve juridike të kontaktoj edhe me drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, dhe në fund të formulohet diçka e tillë çfarë po kërkohet nga ne sot edhe pse duhet ta pranojmë të gjithë se nuk kemi qenë parapamës të mirë kur kemi vendosur për miratimin e Rregullores përkatëse sepse është dashtë që atëherë të rregullohet kjo çështje, pra realisht është faji ynë i të gjithëve që nuk kemi qenë në nivelin tonë profesional.

Pra të formohet komision dhe sa më shpejt që të jetë e mundur të merret me çështjen në fjalë, kurse për numrin e anëtarëve dhe emrat mund të propozohen tani, por që mendoj se nuk ka nevojë të jenë më shumë se tre persona sepse kemi të bëjmë vetëm me një nen apo nën-paragraf të Rregullores, kështu që kjo mund të kryhet brenda 1 ose 2 ditësh, pse jo ndoshta edhe të organizohet debat publik lidhur me këtë temë. Ndërsa çka kthen Ministria pastaj nuk është e jona sepse ne kemi të drejtë të bëjmë plotësim ndryshime të akteve të Kuvendit.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, mendoj se më mirë është të formohet Grup punues sesa komision, kjo për shkak administrative ngase është më funksional dhe më lehtë për tu formuar, kjo për arsye se në rast se formohet komision atëherë duhet me vendim ku pastaj duhet pritur vlerësimin e ligjshmërisë e që kalojnë disa ditë, kurse në rast të formimit të Grupit punues, mbetet vetëm në procesverbal dhe mund të takohen qysh sot apo nesër.

Unanimisht pajtohen që të jetë Grup punues.

Jepen këto propozime, si vijon:

Nga radhët e LDK-së z.Bunjamin Hoti, nga radhët e LVV-së z.Bajram Ajeti, nga radhët e PDK-së z.Bashkim Sylja, dhe 2 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, ku njëri kërkohet të jetë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, të cilët caktohen në ndër kohë.

Njëzëri përkraset, përkatësisht ngritët Grupi punues nga i cili kërkohet që pa vonesë të ulet, të analizoj çështjen në fjalë dhe të del me një përfundim i cili mund edhe të jetë riformulim i dispozitës përkatëse të Rregullores sa i përket kërkesës së pronarëve të dyqaneve të lokalitetit të Orllanit, dhe në fund ta informoj Kuvendin e Komunës rreth mundësive ligjore-procedurale të plotësim ndryshimit të Rregullores për orarin e punës së bizneseve apo çështjeve tjera relevante.

Përbërja e Grupit punues, si në vijim.

1. *Përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës*
2. *Përfaqësues nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik*
3. *z.Buniamin Hoti, nga radhët e LDK-së*
4. *z.Bajram Ajeti, nga radhët e LVV-së*
5. *z.Bashkim Syla, nga radhët e PDK-së*

7. Të ndryshme

z.Vendenis Lahu, theksoi, kam dy çështje, 1-edhe pse drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nuk është prezent këtu, unë dëshiroj të paraqes çështjen që ka të bëjë me gjendjen e shëndetësisë te Emergjencia dhe te Ambulantat e Mjekësisë Familjare në Komunën tonë ku nuk po ka masa mbrojtëse për tu mbrojtur prej coronavirusit, ankesa këto të cilat i kam marrë prej punëtorëve shëndetësor dhe njëkohësisht kërkesë e punëtorëve të këtyre institucioneve për masa mbrojtëse edhe për faktin që tash më kemi rritje të numrit të të infektuarve aq më shumë tash me këtë Ministrin e ri i cili nuk po ia din rendin fare. Pra të fillohet me procedura për furnizim me masa mbrojtëse për këta punëtor sepse përndryshe nga ora në orë pritet të infektohen.

2-çështja tjetër ka të bëjë me pengesat në rrugën “Zahir Pajaziti” të cilat janë paksa të larta dhe vazhdimisht ka kërkesa prej qytetarëve sepse kanë bërë problematike qarkullimin ku në një distancë prej 600 m, kemi 3 pengesa të tilla në mënyrë të paarsyeshme qoftë në numër qoftë në lartësi. Pra këto janë vërejtjet dhe sugjerimet që kam dhe të cilat besoj se i adresohen drejtorit të Drejtorisë përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit, vetëm sa për informim e juaj, për këtë çështjen e dytë, në debatin publik me qytetarë Nënkryetari i Komunës e ka ngritë këtë çështje dhe ka kërkuar të hiqen ato pengesa dhe të ndërtohen sipas standardeve.

z.Pajtim Balaj, theksoi, edhe unë po ashtu kam dy çështje; 1-ka të bëjë me këto gjërmimet që po bëhen nga KEDS dhe punët që po kryhen pas gjërmimeve ku rrugët po lihen në një gjendje goxha të keqe, andaj shtroj pyetje a është duke mbikëqyrë ato punime Drejtoria përkatëse ose a duhet të mbikëqyrë dhe të kërkoj përgjegjësi prej tyre për punët që po i kryen keq përkatësisht po krijojnë gropa e pastaj kjo po ndikon në prishjen e shpejtë të rrugëve.

2-çështja tjetër ka të bëjë me sheshin e qytetit, unë jam takuar me banorët e bllokut qendrorë të banesave të cilët janë ankuar në lidhje me projektin ku siç thonë ata përveç që kanë vështirësi për qasje në parking e kanë edhe vështirësinë tjetër e cila lidhet me rastet emergjente, andaj dëshiroj të pyes se a është planifikuar që në këtë shesh, në rast të ndonjë emergjence (zjarr vënie, sëmundje apo të ngjashme) a kanë qasje dhe mundësi të futjes në shesh autoambulancat / veturat e zjarrfikjes etj.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, a jeni në dijeni se Gjymnazi “Aleksandër Xhuvani” nga shtatori i vitit 2019 e gjer më tani e që pothuajse po bëhet 1 vit nuk ka zëvendës drejtor, për çka pres përgjigje prej drejtorit të Drejtorisë së Arsimit.

Pyetja tjetër, përse ende fshati Peran mbetet i pakëz në Ujësjellës, pyetje të cilën e kam bërë edhe para disa seancave më parë e që drejtori i Drejtorisë përkatëse pati thënë se është çështje ditësh, e që si duket muajt për atë drejtor janë ditë, andaj pres përgjigje konkrete.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, kemi parë që viteve të fundit vërshimet dhe fatkeqësitë e ndryshme natyrore kanë shkaktuar shumë dëme në kultura bujqësore dhe në blegtori në territorin e Komunës së Podujevës andaj duke parë që Komuna ka të themeluar një komision për vlerësimin e dëmeve, dhe raportet vetëm po përcillen në Ministrinë përkatëse dhe nuk po gjejnë mbështetje asnjëherë, kërkoj

nga Ekzekutivi i Komunës krijimin e një fondi të veçantë që t'iu dalim në ndihmë këtyre kategorive. **z.Adnan Zymeri**, theksoi, kërkoj nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që qoftë nga kategoria e mallrave të ndaj një shumë të mjeteve financiare për trajtimin e qenve endacak.

Pajtohem me kolegen znj.Adelinë Stublla e cila më parë e potencoj se është bërë një problem jashtëzakonisht shumë serioz për jetën e secilit nga ne. Ne jemi në dijeni se është përgjegjësi e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës, mirëpo ne nuk kemi kohë të presim atë Agjencion se çfarë veprimesh do të ndërmarrin për evitimin e rrezikut që kanë bashkëqytetarët tanë për çdo ditë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, edhe njëherë më parë e kam paraqitur çështjen e Rregullores për funksionalizimin e këshillave të fshatrave dhe zonave urbane, megjithatë siç po shihet nuk ka asnjë lëvizje nga kjo andaj më shtyri që ta them edhe sot nga fakti që ndihmat e shpërndara në kohën e emergjencës e morëm vesh realisht se kush është kryetar fshati, a janë kryetarët e fshatrave edhe kryetar të partive, kështu që nëse edhe në seancën tjetër të radhës nuk do të vëhet, megjithëse është kryer i gjithë procedimi rreth asaj draft Rregulloreje, madje deri tani është dashtë të bëhet edhe plotësim ndryshimi i asaj Rregulloreje, ne do t'i drejtohem Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me këtë shkëlqje që po bëhet nga pozita këtu në asamblenë tonë.

Edhe njëherë po e them, në rast se në seancën e radhës nuk vëhet rregullorja në fjalë për aprovim, atëherë ne do i drejtohem Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal e cila është e autorizuar të shohë se çfarë shkeljesh keni bërë deri më tani në mos respektim të kësaj rregulloreje.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, kam vërejtje sa i përket dëgjimeve publike për të cilat mendoj se është krijuar një shprehje e keqe ku nuk po ketë informim kur po ka dëgjime publike, madje nuk e di si po njoftohen edhe ata persona që po janë prezent në ato dëgjime kur dihet se nuk ka njoftime as në faqen zyrtare të Komunës, kështu që është mirë të bëhet një rregull që të paktën asamblastët të njoftohen përmes e-maileve sepse siç dihet ne kemi edhe kontakte me qytetarë dhe kemi mundësi t'i informojmë dhe t'i ftojme në ato dëgjime.

z.Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit - DKA, përgjigje znj.Adelinë Stublla, theksoi, sa i përket çështjes së zëvendës drejtorit të Gjimnazit "Aleksandër Xhuvani", po sa të krijohen kushtet e mundshme për t'i zhvilluar procedurat e konkursit, duke pas parasysh situatën nga pandemia, do të zhvillohen procedurat dhe do të rekrutohet zëvendës drejtori përkatës.

Nuk qëndron ajo që u tha se ka 1 vit sepse ka qenë edhe ligji për shërbimin civil i cili ka pas disa barrierë mirëpo mundësia e parë që na ipet do të shpallet konkursi publik.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-600/01-0032337/20
Podujevë,
30 qershor 2020**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**